

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti për Krime të Rënda, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Skender Çoçaj si kryetar dhe gjyqtarët Gani Kastrati dhe Shaban Shala si anëtarë të trupit gjykues, e me procesmbajtësen Birsën Kume, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarve A.V. e V. K. për shkak të veprës penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit në bashkëkryerje nga neni 339 par. 3 lidhur me par. 1 dhe neni 23 të KPK, të akuzuarve A. V., V. K. dhe B. K. për shkak të veprës penale të mashtrimit në bashkëkryerje nga neni 261 par. 2 lidhur me par. 1 dhe neni 23 të KPK, dhe veprës penale të falsifikimit i dokumentit në bashkëkryerje nga neni 332 par. 3 lidhur me par. 1 e lidhur me neni 23 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Prizren PP.nr.205/07 të datës 16.06.2008, në shqyrtimin gjyqësor, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Sefer Morina, të dëmtuarve – përfaqësuesi i Finca A. K. , të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, më datë 01.12.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. A. V., nga i ati L. , i lindur me “data e lindjes..” në Prizren, tani me banim në Fushë Kosovë lagjja “..... ..” hyrja ./.. , i martuar – baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punon në Kompanin si agjent tregtar në F. Kosovë, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. V. K., e lindur me “data e lindjes..”, në fshatin , Komuna e Podujevës, tani me banim në Prizren në rr. “....” nr. ./.. , punon në kompaninë “” – menaxhere, me nr. personal , shqiptar, shtetas e Republikës së Kosovës.

3. B. K., nga i ati B., i lindur me “data e lindjes..”, në fshatin , Komuna e Gjakovës, tani me banim në Gjakovë në rr. “...” nr. ... , me nr. personal , ashkali, shtetas i republikës së Kosovës

I.

Të akuzuarit A. V. e V. K.

JANË FAJTOR

I. Se në periudhën kohore prej dhjetorit të vitit 2006 gjer në maj 2007 të pandehurit A.V. dhe V. K. në cilësi të personave zyrtarë dhe atë i pandehuri A. V. në cilësi të menaxherit të Njësisë në Malishevë-Rahovec, ndërsa e pandehura V. K. në cilësi të referentit, me mos zbatim të qëllimshëm të procedurave të parapara për akordimin e kredive për grupe dhe duke lejuar nënshkrimet e dokumentacionit të duhur nga persona të tjerë duke mos bërë identifikimin e drejtpërdrejt të klientëve –anëtarëve të grupit duke përpiluar aplikime pa dije të personave në emër të të cilëve është bërë akordimi i kredisë duke i bërë pagesat e shumave të mëdha të hollave jashtë zyrave të dëmtuarës Finca dhe duke bërë pagesën e shumave të caktuara të të hollave personave tjerë të cilët nuk kanë qenë bartës të kredive të akorduara kryesisht S. G. , B. G. dhe A. G. me të cilat veprime u kanë mundësuar

të njëjtëve përfitime pasurore në shumën prej 889.637,25 euro, me ç' rast duke i tejkaluar kompetencat dhe duke mos i përmbushur detyrat e parapara zyrtare i shkaktojnë dëm organizatës mikrofinanciare "Finca" në shumën e përmendur.

- Në këtë mënyrë, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit nga neni 339 par. 3 lidhur me par. 1 dhe neni 23 të KPK.

Gjykata në kuptim të dispozitave së lartshënuara dhe neneve: 4, 7, 41, 42, 43, 44, 64 dhe nenit 339 paragr.3 lidhur me par. 1 dhe nenin 31 të KP-së të akuzuarve i shqipton

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit **A. V.** vërtetoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 4 (katër) vitesh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprën të re penale.

Të akuzuarës **V. K.** vërtetoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 4 (katër) vitesh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprën të re penale.

E dëmtuara **Institucioni mikrofinanciar "Finca"**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në konteste të rregullt civil.

Obligohen të akuzuarit **A. V. e V. K.** që ti paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, dhe atë në emër të paushallit gjyqësor secili në shumën prej 500 (pesëqind) euro, të cilën duhet të e paguajnë në afat prej 15 dite, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën ekzekutim të përmbarimit të dhunshëm.

II.

Të akuzuarit A. V., V. K.dhe B. K.

Në bazë të nenit 364 par. 1 pika 1.1 të KPP-së.

LIROHEN NGA AKUZA

II. Se në periudhën kohore prej dhjetorit 2006 gjer në maj të vitit 2007 të pandehurit A. V. dhe V. K. në bashkëpunim me A. G. , B. G. , S. G. , B. G.1 , B. K.1 dhe M.H. gjatë përpilimit të dokumentacionit për kredi grupore e kanë fshehur gjendjen e vërtetë faktike se Sh.Z., A.B. , E.Xh., V. T. , M.M. , M.M.1 , H. M. , F. K. , S. M. , Rr. M. , H. G., A. B. , L. G. , E. D. , F. D. , D.D. , I.G. , A. Sh. , A. G.1 , S. M.1 , J. Q., G. K. , A.G.2 , A. G.3 , A. D. , L. Q. , dhe shumë persona tjerë janë vënë në lajthim të vepronë në dëm të pasurisë së tyre ashtu që çdo njëri ka qenë i dëmtuar në shumën të caktuar të hollash varësisht shumës së akorduar në kuadër të grupit të caktuar njëherit është dëmtuar edhe Organizata mikrofinanciare "Finca" në shumën prej 889.637,25 euro.

- me këto veprime kishin për të kryer në bashkëkryerje veprën penale të mashtrimit nga neni 261 par. 2 lidhur me par. 1 dhe nenin 23 të KPK.

- pasi që nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Shpenzimet e procedurës penale bijën në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

III.

Të akuzuarit A. V., V. K. dhe B. K.

Në bazë të nenit 363 par. 1 pika 1.3 të KPP-së

REFUZOHET AKUZA

III. Se në periudhën kohore prej dhjetorit 2006 gjer në maj të vitit 2007 të pandehurit A. V. dhe V. K. edhe pse e kanë ditur se këtë nuk mund ta bëjnë i kanë plotësuar aplikimet për kredi grupore në emër të personave të ndryshëm siç janë Sh.Z. , A. B., E. Xh., V. T., M. M., M. M.1, H. M. , F. K. , S. M. , Rr. M. , H. G. , A. B., L.G. , E. D., F. D. , D. D., I. G. , A. Sh., A. G.1 , S. M.1 , J. Q. , G. K. , A. G.2 , A. G.3 , A. D. , L. Q. , dhe shumë persona tjerë pa prezencën e tyre vetëm me fotokopje të dokumentit të identifikimit duke u mundësuar A. G., B. G. S. G. ,B. G. , B. K.1 dhe M. H. që të njëjtit të nënshkruajnë në emër të personave të cekur dhe të tjerëve dhe pastaj duke i përdorur të njëjtat si të vërteta u kanë mundësuar ngritjen e të hollave në shumat të caktuara varësisht prej aplikimit të kredisë së akorduar në shumën prej 889.637,25 euro në dëm të organizatës mikrofinanciare “Finca”.

-Kësodore kishin për të kryer në bashkëveprim veprën penale falsifikimi i dokumentit nga neni 332 par. 3 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 23 të KPK,

A r s y e t i m

Prokuroria Publike e Qarkut, në Prizren ka parashtruar aktakuzën PP.nr.205/07 të datës 16.06.2008 (e precizuar në gjykimin e parë në fjalën përfundimtare) kundër të akuzuarve A.V. , V. K., A. G. , B. G. , S.G. , B.G. , M. H. , B. K.1, për shkak të veprave penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit në bashkëkryerje nga neni 339 par. 3 lidhur me par. 1 dhe neni 23 të KPK, për shkak të veprës penale të mashtrimit në bashkëkryerje nga neni 261 par. 2 lidhur me par. 1 dhe nenin 23 të KPK, dhe veprës penale të falsifikimit i dokumentit në bashkëkryerje nga neni 332 par. 3 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 23 të KPK.

Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur vetëm për te akuzuarit A. V., V. K. dhe B. K.1, fillimisht shqyrtimi kryesorë ka filluar për të akuzuarit A. V. dhe V. K. pastaj me aktvendimin e kësaj gjykate P.nr. 9/2014 të datës 16.03.2016 është bashkuar procedura edhe për të akuzuarin B. K. për të cilin ishte ndarë lënda në procedurën e konfirmimit të akuzës dhe zhvillohej lënda P.nr.262/13 kjo për faktin se kanë qenë të përfshirë në të njëjtën akuzë, ndërsa të akuzuarit tjerë nuk kane qene të arritshme për gjykatën dhe ndaj ka qenë e veçuar procedura.

Në shqyrtimin e serishëm, e duke pasur për bazë edhe sugjerimet nga Gjykata e Apelit, është mbajtur shqyrtimi kryesor ku Prokurori i Shteti në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë aktakuzës së ngritur kundër të akuzuarve të lartpërmendur, meqenëse gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale provave të administruara, dëshmisë së dëshmitarëve dhe mbrojtjes së akuzuarve, në mënyrë të plotë dhe të drejtë është vërtetuar gjendja faktike se këtu të akuzuarit në veprimet e tyre i kanë këto vepra penale si pasojë e së cilës të dëmtuarës Finca me veprimet e tyre i kanë shkaktuar dëm material bë vlerë të shumës prej 889.637,25 euro. Më tej ka theksuar se nga provat e administruara është vërtetuar se në institucionin Finca ka ekzistuar doracaku-manuali në të cilën janë paraparë rregullat mbi detyrat dhe obligimet e punës të punësuarve në këtë institucion në

këtë rast edhe të akuzuarve A. V. dhe V. K. , të cilët njëkohësisht kanë qenë edhe udhëheqës apo menaxher përkatësisht nëpunës kreditor, të cilët sipas normave të këtij institucioni kanë pasur për obligim të përmbahen dhe të zbatojnë me përpikëri këto norma me rastin e aprovimit të kredive ndaj klientëve të tyre. Të akuzuarit e lartpërmendur, sipas pasqyrës së të ardhurave të tyre personale kanë pasur vazhdimisht rritje të të ardhurave të tyre, nga stimulimet e parapara të këtij institucioni për shtimin e numrit të klientëve të cilët i kanë siguruar nga akordimi i kredive, dhe me këtë kanë filluar të bashkëpunojnë edhe me të akuzuarit tjerë A. G. , B. G. , S. G. , B. G. , B. K.1 dhe M. H. dhe përmes tyre kanë siguruar grupe kredi marrëse të interesuara gjatë periudhës kohore për të cilën akuzohen, duke vepruar kundërshtim me detyrat e obligimet e parapara me doracak-manual, duke mos ju përmbajtur procedurave të parapara, në veçanti pa prezencën e personave – kredimarrësve verifikimit dhe identifikimit të tyre, biznesit të tyre, sigurimit të ko lateralit si kusht garantues për mundësin e kthimit të kredive, duke iu dhënë pagesat-kredit drejtpërdrejt vetëm të ashtuquajturve kryetar të grupeve kredi marrës apo kredive grupore. Në vazhdim të fjalës së tij ka vazhduar se të tre të akuzuarit duke i fshehur faktet para klientëve të tyre të cilët janë të përmendur dispozitiv të aktakuzës, u kanë thënë se kredit duhet të kthehen nga kryetarët e grupeve kredi marrëse dhe se pa i kthyer kredit secili kredi marrës, për të cilën janë dedikuar të cilët asnjëherë nuk i kanë pranuar, kanë vazhduar të i plotësojnë dokumente të njëjta edhe për shumë hera të tjera për të njëjtit persona, të cilët nuk kanë qenë në dijeni për këto fakte. Andaj, nga të gjitha provat e administruara e veçmas edhe nga mendimi i ekspertit të ekonomisë financiare është vërtetuar se institucionit mikro financiar “Finca2 i kanë shkaktuar dëm të përgjithshëm material në vlerë rreth 900.000 euro, dhe nga të gjitha këto veprime konsideron se është vërtetuar se të akuzuarit me veprimet e tyre i kanë kryer veprat penale, duke propozuar që të njëjtit të shpallen fajto dhe të dënohen sipas ligjit.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar “Finca”, zyrtari Ligjor A. K. i njoftuar nga ana e gjykatës me drejtat që i takojnë sipas ligjit, ka deklaruar se parashtron kërkesë pasurore juridike dhe atë në shumën e lartpërmendur nga prokurori i shtetit, duke shtuar se të akuzuarit pas vete kanë lënë një portofol kreditor toksik prej të cilës Fincës i shkaktajnë probleme edhe sot e kësaj dite, duke pranuar ankesa nga ish klientët të cilat problem i kanë shkaktuar këtu të akuzuarit nga falsifikimi i identitetit të tyre.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. V. - av. P.P. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se aktakuza e prokurorit shtetit si dhe fjala përfundimtare e tij është përgjithësuar dhe është përshkrim i definimeve të veprave penale, në asnjë mënyrë nuk ka dhënë nuk ka dhënë sqarime e as argumente për veprimet individuale apo veprimet në bashkëkryerje konkrete që do të ishin inkriminuese dhe të cilat mund të ishin elemente përbërëse të veprave penale për të cilat është i akuzuar i mbrojturi i tij. Gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka lejuar nënshkrimin e dokumentacionit kreditues nga ana e personave të tjerë, për të pasur një pasqyrë të drejtë për procedura të dhënies së kredisë dhe distribuimit të tyre është dashur të bëhet administrimi në shikimin e dosjeve të kredive të cilat janë nënshtruar ekspertizës përkatëse dhe me këtë do të identifikohet veprimi konkret të secilit përgjegjës në procedurë të lejimit të kredisë dhe meqenëse prokurori i shtetit këtë provë nuk e ka kërkuar, mungesa e saj shkon në favor të mbrojtjes së të akuzuarit. Më tej ka vazhduar se nga dëshmia e shumicës së dëshmitarëve të dëgjuar rezulton se ata për interesin e tyre e vet kanë themeluar grupe të caktuara dhe kanë aplikuar për kredi dhe kredit e lejuar janë ndarë sipas shumave të caktuara për të cilat kanë aplikuar. Po ashtu ka theksuar se nuk është vërtetuar fakti se të akuzuarit gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nuk kanë bërë identifikimin e drejtë të klientëve, këtë fakt gjykata nuk e ka vërtetuar sepse nuk ka pasur mundësi të thellohet në individualizimin e dokumentacionit të secilit klient veç e veç për të parë dhe mundësuar vërtetimin e ndonjë veprimi apo lëshimi konkret të akuzuarit. Po ashtu nuk qëndron edhe fakti i vërtetuar se të akuzuarit kanë aplikuar pa dijen e personit në emrin të cilëve është lejuar kredia, dhe vetëm një fakt prej veprimeve të përmendura është vërtetuar se me disa raste i akuzuari A.V. disburësimin e kredive i ka bërë jashtë

lokalit të institucionit, por sipas dëshmisë së dëshmitares A. V.1 e cila ka deklaruar se kjo mënyrë e shpërndarjes së kredisë ka qenë e pranueshme nga ana e bankës. Prokurori i shtetit vazhdimisht ka përmendur një manual apo Rregullore, mirëpo asnjëherë në procedurën e provave nuk ka theksuar se cili është ai manual për të cilën mbrojtja asnjëherë nuk ka pasur qasje tek ky dokument, të akuzuarit kanë pranuar se në Gusht të vitit 2007 institucioni e ka pruar një manual t procedurave të lejimit të kredive grupore, por në atë kohë të akuzuarit nuk kanë qenë në marrëdhënie pune. Gjithashtu, thekson se mbrojtja ka insistuar që në këtë çështje të bëhet edhe një ekspertizë e re financiare e cila në mënyrë profesionale do të sqaronte pretendimet e akuzës. Ndërsa, sa i përket veprës penale të mashtrimit, prokurori i shteti në shqyrtimet e mëparshme dhe në fjalën e fundit është munduar të i përcaktojë veprimet konkrete për të akuzuarit duke i përmendur të njëjtat veprime që i përkasin veprës penale shpërdorim i detyrës zyrtare dhe prokurori i shtetit në mënyrë të heshtur ka pranuar se kjo vepër është absorbuar nga vepra e parë, prandaj edhe trupi i mëparshëm gjykues të akuzuarit i ka liruar nga akuza. Në fund ka theksuar se trupi gjykues do të marrë një vendim i cili do të jetë në përputhshmëri me gjendjen faktike, respektivisht në mungesë të fakteve dhe provave ndaj të mbrojturit të tij të merr aktgjykim lirues.

Mbrojtësi i të akuzuarës V.K. - av. H. K. , në fjalën e tij përfundimtare, ka deklaruar se përkundër përpjekjeve të gjykatës, mbrojtja konsideron se kanë mbetur shumë gjëra të pasqaruara me vet faktin se kjo lëndë në rigjykim të çështjes nuk i ka përfshirë të gjithë të akuzuarit dhe më pas është ndarë si lëndë e veçantë, ku si pasojë ka ndikuar në vërtetimin e gjendjes faktike, andaj edhe në këtë situatë edhe gjykata dhe si mbrojtja nuk është mundur të vërtetohet faktet dhe provat e propozuara nga prokurori dhe të administruara në këtë rigjykim. Nga provat e administruara në këtë çështje penale dhe nga vlerësimi i tyre, nuk është provuar aktakuza përkitazi me të akuzuarën V. K. dhe se në veprimet e përshkruara në aktakuzë nuk përkojnë me realitetin e ndodhur dhe me pretendimet e pohuara në fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit. Më tej ka vazhduar se mohimi i gjendjes së përshkruar në aktakuzë më së bindshëm argumentohet nga deklarata e dëshmitarëve të dëgjuar, të akuzuarit A. V., zyrtarëve dhe përfaqësuesve të Fincës, dhe më së bindshëm nga vet deklarata e akuzuarës V. K. , të cilës duhet dhënë besimin e duhur, e cila vazhdimisht ka theksuar se në asnjë mënyrë nuk ka bërë shpërdorimin e detyrës zyrtare me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për kredi marrësit S.G., B.G. e A. G. ose personave të tjerë, e as për qëllim që të rritet numri i klientëve, apo të sigurojë realizimin ma të lart të rrogave, sepse pas analizës të gjitha provave së bashku vërtetohet se politika dhe interesi i organizatës ka qenë rritja e numrit të klientëve. Në fakt V. K. ka themeluar marrëdhënien e punës në shtator të vitit 2000 si nëpunëse kreditore, dhe duke qenë se punëdhënësi ka qenë i kënaqur me punën e saj e njëjta ka krijuar marrëdhënie të përhershme të punës, ku ka pasur për detyrë që të dal në teren nëpër fshatra me qëllim të krijimit të grupeve për të ofruar kredi klientëve të cilët nuk kanë ko lateral të mjaftueshëm dhe sigurimin e kthimit në mënyrë të solidare. E mbrojtura e tij V. K. ka pasur për detyrë dhe obligim me përgatit dokumentacionin duke kërkuar dokumente identifikimin të UNMIK-ut ose shifrat e OSCE-së ose fotografitë, duke pasur se shumica as nuk kanë pasur letërnjoftim dhe kanë përgatitur dokumentacion formularin prej zyrës dhe të gjitha këto veprime në përshkrimin e detyrave të vendit të punës kanë qenë të ndërmarra nga udhëzimet e D. K. , S. M.2 dhe udhëheqëseve tjerë të Fincës. Me tej thekson se e mbrojtura e tij gjatë punës me grupet në përbërje prej A. G. , B. G. , S. G. , B. G.1 , M. H. dhe B. K., si udhëheqësit e grupit nuk kanë pasur kurrfarë probleme sepse ata disa herë kanë marrë kredi grupore dhe asnjëherë nuk kanë mbetur borxh deri në qershor të vitit 2007, në fakt kur është vërtetuar krijimi i borxhit për të cilën V. K. nuk ka ditur as nuk ka mundur me ditë, sepse gjendjen është dashur me përcjellë personat të cilët punonin nëpër zyre, e jo nëpunësit e terrenit. Asnjëri prej grupeve dhe individëve që kanë qenë klient – kredi marrës të V.K. as me ekspertizën e ekspertit ekonomik financiar B. I. nuk është konstatuar mungesa ose mospagimi i kredive deri më datën kur ka qenë e suspenduar e akuzuara, fundi i kthimit të pagesave për shumicën e kredi – marrësve ka qenë në fundin e vitit 2007 ose në fillim të vitit 2008, dhe në fakt në rast të mos kthimit të rregullt të kredive e sipas deklaratave të përfaqësuesit të Fincës do të duhej të bërë biseda

nëpunësit me klientët si hapi i parë, biseda të menaxherit me klient, nëpunësit për grumbullimin e huave edhe në rast se nuk do të kishte sukses atëherë bëheshin padi në gjykatë. Ndërsa, nga deklarata e dhënë me shkrim i kredi marrësve të cilët kanë pranuar borxhin e marrë kredi, këto flasin mjaft për të vërtetuar gjendjen faktike, por gjykata njëherit nuk ka siguruar provat me të cilën do të vërtetohet gjendja pas kthimit eventual të borxheve të pranuar, po ashtu nga ana e të akuzuarës as Fondacioni e as një dëshmitarë nuk është mashtruar dhe në dokumentacionin e Fondacionit nuk është bërë shënim i rrejshëm. Andaj, për këto arsye ka propozuar që V. K. të lirohet nga akuza sepse nuk është provuar se e akuzuara ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Gjate shqyrtimit kryesore gjykata i ka nxjerre te gjitha provat e domosdoshme dhe pas analizimit te secilës prove veç e veç dhe te gjitha provave ne tërësi ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Sa i përket veprës penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit nga neni 339 par. 3 lidhur me par. 1 dhe neni 23 të KPK për të akuzuarit A. V. dhe V. K. në tërësi u vërtetua se në periudhën kohore prej dhjetorit të vitit 2006 gjer në maj 2007 të pandehurit A. V. dhe V. K. në cilësi të personave zyrtarë dhe atë i pandehuri A. V. në cilësi të menaxherit të Njësisë në Malishevë-Rahovec, ndërsa e pandehura V. K. në cilësi të referentit, me mos zbatim të qëllimshëm të procedurave të parapara për akordimin e kredive për grupe dhe duke lejuar nënshkrimet e dokumentacionit të duhur nga persona të tjerë duke mos bërë identifikimin e drejtpërdrejt të klientëve –anëtarëve të grupit duke përpiluar aplikime pa dije të personave në emër të të cilëve është bërë akordimi i kredisë duke i bërë pagesat e shumave të mëdha të hollave jashtë zyrave të dëmtuarës Finca dhe duke bërë pagesën e shumave të caktuara të të hollave personave tjerë të cilët nuk kanë qenë bartës të kredive të akorduara kryesisht S. G. , B. G. dhe A. G. me të cilat veprime u kanë mundësuar të njëjtëve përfitime pasurore në shumën prej 889.637,25 euro, me ç’ rast duke i tejkaluar kompetencat dhe duke mos i përmbushur detyrat e parapara zyrtare i shkaktojnë dëm organizatës mikrofinanciare “Finca” në shumën e përmendur.

Ndërsa sa i përket veprës penale me asnjë prove nuk është vërtetuar se të akuzuarit A. V. , V. K. dhe B. K. , kanë kryer veprën penale të mashtrimit në bashkëkryerje nga neni 261 par. 2 lidhur me par. 1 dhe nenin 23 të KPK.

Per vërtetimin e gjendjes faktike gjykata ka dëgjuar dëshmitaret, V. H.-P., E.P. , M. K. , Y. B., M. M., J.Q., Rr.M. , L.Q.1 , A.G.3 , H.M., M.S., N.K. , F. K.1 , F. Z. , A.D., F. B. , L. G.1 , J. H., A. A. , A.A.1, A.B.1, K. G., A.G.1 , S.M.1 , G.K. , A.V.1, ka lexuar deshmite e deshmitarve S.M.2 dhe D. K. ish zyrtar ne FINCA (vendndodhja e te cileve ka qene e pa mundur te sigurohet), eshte lexuar deshmia e deshmitarve A.G.4 , A.G.3 , B. K., F.D.1, A.H., B.G.2 , A.B. , M.J., ka administruar edhe provat materiale dhe ate, jane lexuar deklaratat e S.G. , A.G. , eshte lexuar raporti i Finca per periudhen janar 2006, dhjetor 2007, Raportet kuartale te FINCA, kontratat e punes per te akuzuarve A.V. dhe V.K., Letra paralajmeruese per suspendimin e te akuzuarve A.V. dhe V.K., Letra Perfundimtare e pushimit te mardhenjes se punes per te akuzuarve A.V. dhe V.K. , eshte administruar ekspertiza financiare dhe aneksekspertiza financiare e pregaditur nga eksperti B.I. , eshte lexuar deshmia e ekspertit B.I. (pasi qe i njejti ka nderruar jete).

Nga dëgjimi i dëshmitarit V.H. – P. , ka deklaruar se ka punuar në “Finca” si analiste e kredisë dhe detyra e saj ka qenë përgatitja e dokumentacionit për personat të cilët kanë kërkuar kredi, vizitat në shtëpi apo lokalitete të tij, dhe këto vizita janë bërë me qëllim të verifikimit se personat a i plotësojnë kushtet për dhënien e kredisë. Pas përgatitjes së dokumentacionit për marrjen e kredisë kjo çështje pastaj është shqyrtuar në komitet dhe pastaj shefi – menaxheri ka vendosur për aprovimin e kredisë apo jo i cili në atë kohë ka qenë A.V. , ndërsa e akuzuara V.K. në atë kohë ka qenë poashtu kolege

dhe e njëjta ka pasur pozitën e njëjtë si të dëshmitares si analiste e kredisë, ndërsa të akuzuarin B.K. nuk e njeh.

Nga dëshmia e dëshmitares V.H. – P. gjykata ka vërtetuar se i akuzuari A.V. ka punuar si menaxher ndërsa e akuzuara V.K. ka punuar analiste e kredisë në “Finca”, ndërsa të akuzuarin B.K. nuk e ka njohur.

Nga dëgjimi i dëshmitarit Y.B. , ka deklaruar se në vitin 2006-07, mund të ketë marrë kredi në bankë tjera por në “Finca” nuk ka marrë, dhe se asnjë person nga ai nuk ka kërkuar letërnjoftimin për të marrë kredi në këtë institucion, asnjërin prej të akuzuarve nuk i njeh.

Nga dëgjimi i dëshmitarit M.M. , ka deklaruar se ai vet asnjëherë nuk ka aplikuar dhe as që ka marrë kredi në Institucionin Mikrofinanciar “Finca”, por gjatë vitit 2007 e kanë ftuar në këtë institucion dhe i kanë thënë se ka borxh (shuma e të cilës nuk i kujtohet), sepse B.G. ka marrë kredi në Malishevë me emër të tij dhe me letërnjoftimin e tij, të cilin fakt e ka mohuar pasi që nënshkrimi në aplikacion nuk ka qenë i tij. Në vazhdim thekson se i kujtohet se në atë kohë B.G. i kishte kërkuar letërnjoftimin e tij për të regjistruar një veturë të cilit edhe ia ka dhënë, por se pas asaj më nuk ishte parë me të, pasi që i njëjti kishte ikur për në Sërbë, borxhin të cilin e kishin marrë në emër të tij banka nuk e kishte liruar, ndërsa për të akuzuarin V.K. kishte dëgjuar se përmendej emri i saj por me të asnjëherë nuk kishte kontaktuar.

Nga dëgjimi i dëshmitarit J.Q. , ka deklaruar se ai gjatë vitit 2006-07, asnjëherë nuk kishte aplikuar për marrjen e kredisë në “Finca”, por gjatë vitit 2008 nga familjarët e tij ishte njoftuar se zyrtarët e këtij institucioni kishin shkuar në shtëpinë e tij në Nashec për të kërkuar borxhin e mbetur në shumën prej 350 euro për një kredi të marrë në shumën prej 1000 euro. Pas takimit me zyrtarët e këtij institucioni ka kuptuar se është një borxh në emër të kredisë që ishte marrë në emër të tij. Në vazhdim ka theksuar se viti nuk i kujtohet por se F.M. , të cilin e ka shok që nga shkolla e mesme ia kishte kërkuar letërnjoftimin e tij, të cilit edhe i kishte dhënë kopjen e letërnjoftimit pa e pyetur se për çka i nevojitet, dhe pas kërkimit të borxhit nga “Finca”, ka shkuar disa herë që të takon, por se të njëjtin nuk e kishte gjetur në shtëpi. Në fund thekson se borxhin e mbetur nuk e ka paguar asnjëherë pasi që këtë kredi ai nuk e kishte marrë.

Nga dëgjimi i dëshmitarit Rr.M., i cili ka deklaruar se në “Finca”, nuk ka marrë asnjëherë kredi, por me një rast ka aplikuar në këtë institucion për të marrë kredi në shumën prej 1500 euro, me ç’rast edhe kishte dorëzuar të gjitha dokumentet, por se kredinë nuk e kishte marrë sepse e kishte telefonuar komshiu i tij B.G. , i cili i kishte thënë të mos merr kredi në atë bankë dhe për këtë rast kishte biseduar edhe me A.V. përmes telefonit të tij i cili i kishte thënë të mos kredi aty se është problem për pagesa, është bankë e rrezikshme. Në vazhdim ka theksuar se një zyrtar i bankës me mbiemrin S. kishte ardhur në shtëpinë e tij ka kërkuar nga ai nënshkrimin për të verifikuar në bankë lidhur me kreditë që kanë marrë, dhe pas ftesës së policisë B.G. kishte ardhur tek ai dhe i ka thënë “nuk është problem unë do të paguaj kredinë që është marrë në emrin tuaj”, dhe të nesërmen pas dite ka kuptuar se B.G. kishte ikur nga Kosova. Në fund ka theksuar se M.M. e ka djalë të vëllait dhe në atë kohë ai ia kishte marrë letërnjoftimin të cilin e kishte kërkuar B.G. dhe i cili person është kryesori që i ka bërë këto malverzime, duke i rrejtur dhe sjellë në një gjendje jo të mirë.

Nga dëgjimi i dëshmitarit L.Q.1 , i cili në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se para vitit 2007, personalisht ai nuk ka aplikuar dhe nuk ka marrë kredi në bankën Finca, mirëpo i kujtohet se në atë kohë B.G. , mbiemrin e të cilit nuk ia din ja ka kërkuar letërnjoftimin e tij për të marrë një kredi dhe me atë rast së bashku me të kanë shkuar në një shtëpi-bankë për të nënshkruar për një kredi në shumën prej 800 euro, në të cilin rast ai kishte qenë si garantues për këtë kredi.

Nga dëgjimi i dëshmitarit A.G.3 , i cili në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se gjatë vitit 2006/07, ai nuk ka aplikuar asnjëherë për kredi në Finca dhe as që ka marrë ndonjëherë kredi në këtë bankë. Por, gjatë kësaj kohe njëherë ishte takuar me S.G. , dhe ai me atë rast i kishte kërkuar letërnjoftimin e tij, duke i thënë se i nevojitet për të marrë një kredi në një bankë (duke mos i treguar se në të cilën), dhe në lokalin e S.G. ia kishte dhënë letërnjoftimin ku edhe ka nënshkruar disa dokumente të cilat nuk i ka lexuar, dhe me këtë rast S.G. i kishte dhënë 10 euro. Në vazhdim ka theksuar se në atë kohë ka qenë i pa punë, dhe një ditë në shtëpinë e tij kishin ardhur zyrtarët e Fincas dhe të njëjtët i kishin thënë se i ka borxh bankës për kredi në shumën prej 800 euro, porse atyre i kishte thënë se këtë kredi ai nuk e ka marrë dhe për këtë nuk ka qenë në bankë dhe as që di se çka ka ndodhur lidhur me këtë. Pas këtij rasti ka tentuar që të kontaktoj me S.G. , porse i njëjti më nuk jeton në mahallën e tyre.

Nga dëgjimi i dëshmitarit E.P., i cili në dëshminë e tij në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se deri në vitin 2007 ka punuar në Finca në detyra të ndryshme, ndërsa gjatë vitit 2006/07 ka qenë menaxher operacional, oficer i lart kreditor, ndërsa A.V. dhe V.K. gjatë kësaj kohe kanë punuar në këtë institucion, ndërsa B.K. nuk e njih. Në atë kohë A.V., ka qenë menaxher i degës në Malishevë, i cili i ka raportuar Bordit drejtues, gjegjësisht atij si menaxher dhe drejtues i financave, ndërsa V.K. ka qenë nëpunëse kreditore po ashtu në Malishevë, e cila ka raportuar menaxherit të degës – A.V. . Detyrat e V.K. si analiste e kredisë kanë qenë gjetja e klientëve potencial, promovimi i programit, analizimin e biznesit të klientëve, përgatitja e dokumentacionit dhe propozimi i kredive në komitet. Në vazhdim ka theksuar gjatë kësaj kohe deri në vitin 2006/07 fillimisht nuk janë vërejtur parregullsitë e të akuzuarve, por në momentin e ndaljes së shpërndarjes së kredive janë paraqitur vonesat e kredive dhe me atë rast janë bërë vizitat e klientëve, ku njëri prej klientëve kishte deklaruar se është përgjegjës për disa anëtarë të grupeve të cilët kanë marrë kredi dhe nga kjo deklaratë ka rezultuar se ai nuk ka pasur të drejtë që të marrë kredi në emër të personave tjerë, dhe me këtë rast punëtorët V.K. dhe menaxheri i degës janë larguar nga puna. Më tej ka theksuar se aprovimin kredisë e ka bërë komiteti kreditor të cilin e ka sjellë nëpunësi kreditor, ndërsa ai si menaxher ka qenë pjesë e këtyre komiteteve kreditor për shumta të mëdha mbi limitet e caktuar për menaxherët e degëve, pra në shumat prej 10.000 deri në 70.000 euro. Gjatë punës në këtë institucion financiar ka pasur manualë të vazhdueshme për lejimin e kredive dhe instruksionet se si të përdoren ato, të cilët vazhdimisht janë përditësuar, ndërsa për ndryshimet e tyre ka ndodhur që menaxherët e degëve janë konsultuar me dëshmitarin si menaxher më i lartë. Në rastet kur është bërë aprovimi i kredisë për shumat e vogla kontrollimin e dokumenteve e ka bërë menaxheri i degës, ndërsa për shumat e mëdha drejtori dhe pas në Drejtorinë për financa. Në vazhdim ka sqaruar se me grup kreditor kuptojmë një grup solidar ku janë të paraparë të jenë minimum prej 4 ose 6 persona ose më shumë, të cilët njihen me njëri tjetrin dhe të cilët kanë garantuar për njëri tjetrin, ku edhe me atë rast kanë aplikuar për shumat që i nevojiten për biznes çdonjëri në mënyrë individuale për veti, analizat për dhënien e kredisë në grup është bërë në mënyrë individuale por edhe si grupe, ndërsa pas aprovimit të kredisë kredia është dhënë në mënyrë individuale, pra asnjë anëtar nuk ka pasur të drejtë që të tërheq kredinë për një anëtarë tjetër, kredi është tërhequr personalisht në arkën e Fincës, pra këtë kredi nuk ka mundur që të tërheq menaxheri apo ndonjë nëpunës tjetër në këtë bankë. Sipas rregullores interne të bankës kredi marrësi dhe garantuesit kanë qenë të obliguar me u paraqit personalisht në zyrat e Fincës të legjitimohen dhe të e nënshkruajnë dokumentet përkatës bankare.

Nga dëgjimi i dëshmitarit M.K. , i cili në dëshminë e tij në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se qëndron pranë deklaratë së dhënë në prokurori dhe para trupit gjykues me datë 11.01.2010, duke deklaruar se gjatë viti 2007 ka punuar në zyrën e Finca në Prizren si auditor i brendshëm senior, dhe gjatë këtij viti në punën e tij gjatë procesit të auditimit ka gjetur moszbatim të kritereve të kreditimit nga ana e të akuzuarve ashtu siç kërkohet me procedurat dhe për këtë rast ka njoftuar anëtarët e bordit menaxhues. Gjatë kësaj periudhë kohore i akuzuari A.V. ka qenë menaxher i degës në Malishevë,

ndërsa e akuzuara V.K. ka qenë analiste kreditore në Malishevë e cila është marrë edhe me një numër të caktuar të klientëve në Prizren, ndërsa detyra e V.K. ka qenë gjetja e klientëve, plotësimi i dokumentacionit të caktuar, dhe këto më pas i ka prezantuar në komitet kreditor ku së bashku me menaxherin e degës në komitet i kanë aprovuar këto kredi me rastin e vendosjes për kërkesat në fjalë, të cilat komitete të kredive janë mbajtur në të gjitha degët bankës, përveç shumave të mëdha të cilat e tejkalojnë kompetencën e menaxherit. Sipas rregullores së brendshme gjatë vitit 2006 për kredit grupore ka qenë e mundur të jepet kredia në vend të biznesit (klientit), ndërsa në vitin 2007 klienti është dashur personalisht që të jetë në zyrat e Fincës me dokumente personale për të tërhequr kredinë, ndërsa për marrjen e kredisë secili anëtarë i grupit kanë pasur për obligim të nënshkruajnë personalisht dokumentet kredisë dhe tërheqjen e kredisë. Më tutje ka sqaruar se kredit grupore dallohen prej kredive individuale për shkak të anëtarësisë dhe në bazë të rregullores ka funksionuar në baza solidare, ku është kërkuar pjesëmarrja e minimum 3 anëtarëve të grupit pa kolateral dhe është dhënë në baza solidare në mes tyre dhe në rast se një anëtarë i grupit nuk e paguan kredinë atëherë anëtarët e tjerë duhet të e mbulojnë borxhin e atij anëtarit. Më tutje dëshmitari ka theksuar se nga të gjeturat në raportin e auditimit ka qenë mos zbatimi i rregullores së brendshme të kreditimit, siç janë dhënia e kredisë për personat të cilat nuk i kanë plotësuar kushtet për marrjen e kredisë, po ashtu dhënia e kredisë për klientë jo ekzistues të cilët nuk kishin aplikuar për kredi, (është dhënë kredia pa dijen e klientëve). Deri tek ky konstatim gjatë auditimit ka ardhur gjatë kontrollimit të dokumentacionit të klientëve, takimi me klientë, takimin me tre përgjegjësit për mbledhjen e klientëve, si dhe nga deklaratat e klientëve se të njëjtit nuk kanë marrë kredinë, të njëjtit nuk janë nënshkruar të marrëveshjeve për kredinë, po ashtu disa prej klientëve kanë deklaruar se kanë nënshkruar marrëveshjet por se kanë marrë parat vetëm për nënshkrim. Ndërsa, prej personat përgjegjës për mbledhjen e klientëve, dëshmitari është takuar me A.G. , i cili kishte marrë një shumë të caktuar të kredive përmes personave të tjerë, ku kishte ardhur në zyrat e Fincës dhe ka deklaruar se është posedues i 12 apo 13 kredive në atë kohë të cilat i ka marrë me klientë të cilët kanë nënshkruar dhe një numër të klientëve që nuk kanë qenë prezent por kanë marrë kredinë nga punëtorët A.V. dhe V.K. , përveç këtij personi në këto parregullsi ka qenë të përfshirë edhe B.G. , S.G. , dhe djali i S.G. , B.G.3 i cili ka dhënë deklaratën e njëjtë si të A.G. se ka qenë i përfshirë në parregullsi, të cilët edhe në deklaratën e tyre në muajin gusht të vitit 2007 njëherit e kanë pranuar si detyrim karshi Fincës shumë në rreth 890.000 euro. Dëshmitari më tutje ka theksuar se në Kosovë Finca vepron si degë e Finca internacionale me seli në Uashington, e cila është subjekt i pavarur brenda tregut financiar të Kosovës, e cila raporton BQK-së, dhe njëherit për humbjet e pësuar gjatë vitit 2006-07, i ka raportuar asaj, ndërsa gjatë vitit 2006/07 drejtor operativ në Finca ka qenë E.P. .

Nga dëshmia e dëshmitarit M.K. gjykata ka vërtetuar se dëshmitari si auditor i brendshëm senior në Finca, gjatë procesit të auditimit ka gjetur mos zbatim të kriterëve të kreditimit siç kërkohet me procedurat, nga ana e të akuzuarve A.V. dhe V.K. , mos zbatimi i rregullores së brendshme të kreditimit duke ju dhënë kredi për personat të cilat nuk i kanë plotësuar kushtet për marrjen e kredisë, po ashtu dhënia e kredisë për klientë jo ekzistues të cilët nuk kanë aplikuar për kredi, (është dhënë kredia pa dijen e klientëve). Deri tek ky konstatim gjatë auditimit ka ardhur gjatë kontrollimit të dokumentacionit të klientëve, takimi me klientë, takimin me tre përgjegjësit për mbledhjen e klientëve, si dhe nga deklaratat e klientëve se të njëjtit nuk kanë marrë kredinë, të njëjtit nuk janë nënshkruar të marrëveshjeve për kredinë, po ashtu disa prej klientëve kanë deklaruar se kanë nënshkruar marrëveshjet por se kanë marrë parat vetëm për nënshkrim. Ndërsa, prej personat përgjegjës për mbledhjen e klientëve, dëshmitari është takuar me A.G. , i cili kishte marrë një shumë të caktuar të kredive përmes personave të tjerë, ku kishte ardhur në zyret e Fincës dhe ka deklaruar se është posedues i 12 apo 13 kredive në atë kohë të cilat i ka marrë me klientë të cilët kanë nënshkruar dhe një numër të klientëve që nuk kanë qenë prezent por kanë marrë kredinë nga punëtorët A.V. dhe V.K. , përveç këtij personi në këto parregullsi ka qenë të përfshirë edhe B.G. , S.G., dhe djali i S. G. , B.G.3 i cili ka dhënë deklaratën e njëjtë si të A.G. se ka qenë i përfshirë në parregullsi, të cilët edhe në

deklaratën e tyre në muajin gusht të vitit 2007 njëherit e kanë pranuar si detyrim karshi Fincës shumë diku rreth 890.000 euro.

Nga dëgjimi i dëshmitarit H.M., i cili ka deklaruar se qëndron pranë deklaratës së dhënë në dhënë në prokurori dhe para trupit gjykues të dhen më herët, si dhe në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se në Finca asnjëherë nuk ka aplikuar dhe as që ka marrë kredi, ndërsa personin me emrin B.G. e njeh pasi që të njëjtin e ka kojshi, ndërsa A.V. , V.K. dhe B.K. nuk i njeh. Në vazhdim ka theksuar se viti nuk i kujtohet saktë se a ka qenë 2007-2008, me B.G. ishte takuar dhe i njëjti e kishte lutur duke i thënë “ baca H.M. a mundesh me ma dhënë letërnjoftimin se më ka lind një fëmijë dhe dua me regjistrua në Kuvendin Komunal”, të cilit edhe me atë rast edhe ia kishte dhënë letërnjoftimin e tij duke e pyetur B.G. se a ka nevojë për me ardhë edhe ai, por i njëjti ishte përgjigjur se nuk ka nevojë që të vjen, ndërsa po atë ditë pas një orë – një orë e gjysme B.G. ia kishte kthyer letërnjoftimin, dhe për këtë nga ai nuk kishte marrë asnjë shpërblim. Më tej ka theksuar se po ashtu viti nuk i kujtohet por në shtëpinë e tij ka ardhur zyrtari i Fincës Gj.S. , dhe i ka thënë se ka borxh në Finca, pasi që ishte formuar një grup dhe kanë marrë kredi, për të cilin fakt ishte befasuar shumë pasi që asnjëherë nuk kishte kërkuar kredi në këtë bankë, dhe për këtë çështje kishte shkuar në Finca ku ishte takuar me zyrtarët V. O. dhe Gj.S. dhe i ka pyetur se qysh mundet me marrë kredi kur nuk ka dhënë asnjë nënshkrim, mirëpo këta zyrtarë i kishin thënë se në dokumentacion po figuron letërnjoftim i tij dhe një nënshkrim (i cili nënshkrim e kishte mohuar se ishte i tij), dhe sipas këtyre zyrtarëve borxhi i kredisë ka qenë diku rreth 20.000 euro. Në vazhdim ka theksuar se për këtë borxh të kredisë nga ana e Fincës ishte paditur në gjykatë, e cila evidentohet sipas numrit të rastit E.nr.42/08.

Nga dëshmia e dëshmitarit H.M. gjykata ka vërtetuar se i njëjti në “Finca” asnjëherë nuk ka aplikuar dhe as që ka marrë kredi. B.G. te cilin e kishte kojshi e kishte lutur duke i thënë “ baca H.M. a mundesh me ma dhënë letërnjoftimin se më ka lind një fëmijë dhe du me regjistrua në Kuvendin Komunal”, të cilit edhe me atë rast edhe ia kishte dhënë letërnjoftimin e tij pas një orë – një orë e gjysme B.G. ia kishte kthyer letërnjoftimin, dhe për këtë nga ai nuk kishte marrë asnjë shpërblim. Në shtëpinë e tij kishin shkuar zyrtari i Fincës Gj.S. , dhe i kishte thënë se ka borxh në “Finca”, pasi që ishte formuar një grup dhe kanë marrë kredi, për kete ishte befasuar shumë pasi që asnjëherë nuk kishte kërkuar kredi në këtë bankë, për çka kishte shkuar në Finca ku ishte takuar me zyrtarët V. O. dhe Gj.S. ku i ka pyetur se qysh mundet me marrë kredi kur nuk ka dhënë asnjë nënshkrim, mirëpo këta zyrtarë i kishin thënë se në dokumentacion po figuron letërnjoftim i tij dhe një nënshkrim (nënshkrimin e kishte mohuar se ishte i tij), dhe sipas këtyre zyrtarëve borxhi i kredisë ka qenë diku rreth 20.000 euro.

Nga dëgjimi i dëshmitarit M.S., i cili në dëshminë e tij në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se gjatë viteve 2005, 2006 dhe 2007 në Finca kredi nuk kishte marrë, por në vitin 2004 B.G. të cilin e ka komshi i kishte kërkuar letërnjoftimin e tij me arsyetim se po don me marrë një kredi për veti, dhe me atë rast ia kishte dhënë letërnjoftimin, mirëpo atë ditë B.G. nuk kishte thënë se ai duhet të shkon me të në bankë apo të nënshkrua ndonjë dokument, dhe pas 10 minutave i njëjti ja kishte kthyer letërnjoftimin e tij. Ndërsa, pas këtij rasti në shtëpinë e tij kishin ardhur zyrtarët e bankës Finca dhe i kishin thënë se ka borxh për kredinë, që e kishte marrë në emër të grupit prej 5 personave, në shumë prej 10.000 eurove. Më tutje ka shtuar se zyrtarët e bankës kanë kërkuar nga ai që të nënshkruajë me qëllim të verifikimit të nënshkrimit të tij dhe deri më sot nuk ka kthyer borxhin e kredisë të cilin ai nuk e kishte marrë.

Nga dëshmia e dëshmitarit M.S. gjykata ka vërtetuar se i njëjti nuk ka marrë kredi në “Finca” por B.G. te cilin e kishte komshi i kishte kërkuar letërnjoftimin e tij me arsyetim se po don me marrë një kredi për veti, dhe me atë rast ia kishte dhënë letërnjoftimin por nuk kishte nënshkruar ndonjë dokument për marrjen e kredisë, pas 10 minutave i njëjti ja kishte kthyer letërnjoftimin e tij. Në

shtëpinë e tij kishin shkuar zyrtarët e bankës “Finca” dhe i kishin thënë se ka borxh për kredinë, që e kishte marrë në emër të grupit prej 5 personave, në shumën prej 10.000 eurove gjithashtu zyrtarët e bankës i kishin kërkuar që të nënshkruajë me qëllim të verifikimit të nënshkrimit të tij dhe se deshmitari nuk e ka kthyer borxhin e kredisë sepse ai nuk e kishte marrë kete kredi.

Nga dëgjimi i dëshmitarit N.K. , gjykata ka vërtetuar se se gjatë vitit 2006/2007 në institucionin mikrofinanciar “Finca” i njejt i ka marrë kredi në shumën prej 3000 € të cilën kredi edhe ka paguar me sukses. Gjatë kësaj periudhe kohore nuk ia kishte dhënë ndonjëherë dikujt letërnjoftimin e tij dhe nga kjo bankë nuk kishte pasur mosmarrëveshje apo ndonjë thirrje për vonesë të kredisë.

Nga dëgjimi i dëshmitarit F.K.1 , i cili në dëshminë e tij në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se të akuzuarit A.V. dhe V.K. i njeh nga koha kur ka marrë kredi në Finca, ndërsa të akuzuarin B.K. nuk e njeh. Në vazhdim dëshmitari ka theksuar se viti nuk i kujtohet saktë a ka qenë 2006/07, por se në Finca ka marrë dy herë kredi, një kredi individuale për të cilën ka aplikuar personalisht në bankë, ndërsa për kredinë grupore të akuzuarit A.V. dhe V.K. kanë qenë në shtëpinë e tij dhe për këto kredi të cilat ka aplikuar borxhet i ka kthyer në tërësi, dhe asnjë mosmarrëveshje deri në kthimin e borxhit me Fincën nuk ka pasur.

Nga deshmia e dëshmitarit F.K.1 gjykata ka vërtetuar se i njejt i akuzuarit A.V. dhe V.K. i njeh nga koha kur ka marrë kredi në Finca, ndërsa të akuzuarin B.K. nuk e njeh. Në Finca ka marrë dy herë kredi, një kredi individuale për të cilën kishte aplikuar personalisht në bankë, ndërsa për kredinë grupore të akuzuarit A.V. dhe V.K. kanë qenë në shtëpinë e tij dhe për këto kredi të cilat ka aplikuar borxhet i ka kthyer në tërësi, dhe asnjë mosmarrëveshje deri në kthimin e borxhit me Fincën nuk ka pasur.

Nga dëgjimi i dëshmitarit F.Z. , i cili në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se të akuzuarit i njeh, të njëjt i kishte parë në dyqanin e B.K. kur ka shkuar të nënshkruajë për kredi, dhe në atë moment në dyqan kanë qenë gjithsej 5 persona të cilët kanë nënshkruar për të marrë kredi B.K. , pra secili me nga 500 euro, ku gjithsej atë ditë B.K. i ka marrë 2500 euro, në lidhje me furnizimin e dyqanit të tij. Më tutje ka shtuar gjatë vitit 2006/07, ai personalisht në Finca nuk kishte marrë kredi, mirëpo një ditë pas pranimit të një letre nga gjykata ai kishte vizituar zyret e Fincës për të pyetur rreth kësaj çështje dhe nga aty ka kuptuar se ai ka për të paguar 2500 euro për kredi të cilën nuk e kishte marrë, dhe nga zyrtarët e Fincës ishte udhëzuar që rastin të e lajmërojë në polici në Prizren, të cilën rast edhe e kishte lajmëruar. Në vazhdim ndër të tjera thekson se B.K. në atë kohë nuk i ka treguar se punon në Finca dhe konsideron se në atë kohë nuk ka qenë i mashtruar nga ai.

Nga dëgjimi i dëshmitarit Xh.R. , i cili në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se të akuzuarit i njeh, ndërsa të akuzuarin A.V. dhe V.K. për herë të parë i kishte parë në dyqanin e B.K. , kur të njëjt i kishin dhënë të hollat në një zarf të bardhë. Gjatë vitit 2006/07, ai personalisht nuk ka qenë i interesuar për të marrë kredi, por se në atë kohë Bajrami i kishte kërkuar letërnjoftim e tij për të marrë një kredi deri në shumën prej 2500 euro në lidhje furnizimin e dyqanit të tij, dhe për këtë arsye ishin mbledhur 5 persona në dyqanin e B.K. për të marrë kredi secili prej tyre me nga 500 euro për nevojat e B.K. , ku me atë rast ka nënshkruar me 5 dokumente, dhe gjatë nënshkrimit të këtyre dokumenteve ka menduar se është në cilësinë e dëshmitarit dhe jo të garantuesit, ndërsa për këtë rast B.K. mendon se nuk ka qenë i mashtruar nga B.K. .

Nga dëgjimi i dëshmitarit A.D. , i cili në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se të akuzuarit i njeh, për herë të parë i ka parë në dyqanin e B.K. , ku kishin qenë edhe 5 persona të tjerë si garantues për

marrjen e një kredi në shumën prej 2500 eurove për B.K. . Për marrjen e kësaj kredi, të akuzuarit nga ai kanë kërkuar letërnjoftimin dhe nënshkrimin e dokumenteve, ndërsa pas kësaj A.V. dhe V.K. në zarf ia kishin dhënë parat B.K. . Në vazhdim thekson se për kredinë që e kishte marrë B.K., ai nuk ka pasur njohuri se ajo duhet të kthehet në rast të vonesës së tij, dhe për këtë vonesë ka kuptuar kur në shtëpinë e tij kanë ardhur dokumentet nga banka Finca se kredia nuk është paguar. Ai personalisht gjatë viteve 2006/07 në këtë bankë nuk ka marrë kredi, ndërsa për kredinë të cilën e ka nënshkruar si garantues konsideron se nuk ka qenë i mashtruar nga B.K. .

Nga dëshmia e dëshmitarëve F.Z. , Xh.R. dhe A.D. gjykata ka vërtetuar se te njëjtit të akuzuarit i njihnin, për herë të parë i kishin parë në dyqanin e B.K. , ku kishin qenë 5 persona të tjerë si garantues për marrjen e një kredi në shumën prej 2500 eurove për B.K. . Për marrjen e kësaj kredi, të akuzuarit nga ai kanë kërkuar letërnjoftimin dhe nënshkrimin e dokumenteve, ndërsa pas kësaj A.V. dhe V.K. në zarf ia kishin dhënë parat B.K. . Dëshmitaret nuk kishin pasur njohuri se ajo duhet të kthehet në rast të vonesës dhe për këtë vonesë ka kuptuar kur iu kishin ardhur dokumentet nga banka Finca se kredia nuk është paguar, dëshmitarët për kredinë të cilën e ka nënshkruar si garantues sipas dëshmitarëve nuk ka qenë te mashtruar nga B.K. .

Nga dëgjimi i dëshmitarit F.B. , i cili në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se ai personalisht në Finca nuk ka aplikuar për kredi, ndërsa gjatë vitit 2006/07 letërnjoftimin e tij ja kishte dhënë I.G. (mik i gruas), për të marrë një kredi në Finca, në shumën prej 4000 eurove, ndërsa për këtë kredi I.G. i kishte thënë se do të jetë si dëshmitarë. Gjatë nënshkrimit të kredisë ka shkuar në Finca dhe me atë rast gjatë nënshkrimit prezent kanë qenë të akuzuarit A.V. dhe V.K. , të cilët i kanë thënë se është dëshmitarë për të marrë kredin miku i gruas së tij I.G. , dhe se pas kësaj të akuzuarit A.V. dhe V.K. të hollat e kredisë ia kanë dhënë I.G. . Në vazhdim thekson se borxhin e kredisë në Finca ishte detyruar që të e kthejë në shumën prej 600 euro, për arsye se ai personalisht ka dashur të merr një kredi në bankën TEB, ndërsa këto para nga Ismeti nuk i kishte marrë pasi që i njëjti kishte vdekur.

Nga dëgjimi i dëshmitarit L.G.1 , i cili në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se nuk i kujtohet saktë koha por gjatë vitit 2006/07 letërnjoftimin e tij ia kishte dhënë S.G. , i cili ja kishte kërkuar për të marrë një kredi në Finca, dhe me atë rast ka shkuar në tezgën e tij e cila gjendet në Qylhan dhe me atë rast ka nënshkruar për kredi, ndërsa këtu të akuzuarit nuk i njeh.

Nga dëshmia e dëshmitarit L.G.1 gjykata ka vërtetuar se i njëjti gjatë vitit 2006/07 letërnjoftimin e tij ia kishte dhënë S.G., i cili ja kishte kërkuar për të marrë një kredi në Finca, dhe me atë rast ka nënshkruar për kredi, ndërsa të akuzuarit nuk i njeh.

Nga dëgjimi i dëshmitarit J.H. , i cili në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se në Finca gjatë viteve 2006/07, asnjëherë nuk ka aplikuar për të marrë ndonjë kredi, dhe gjatë kësaj kohe nga ai askush nuk ka kërkuar letërnjoftimin e tij për marrjen e ndonjë kredi në Finca. Më tutje shton se në shtëpinë e tij ka qenë tre persona, dhe njëri prej tyre është prezantuar si drejtor i “Fincës”, ku i kishte thënë se ai ka një kredi prej 350 eurove, dhe këtë kredi duhet të e paguajë dhe pastaj përsëri mundet të aplikon, por me atë rast atyre i ka thënë se këtë kredi ai nuk e kishte marrë në Finca, dhe për këtë çështje ka dhënë një deklaratë në prokurori. Në vazhdim ka theksuar se në atë kohë ka pasur mundësi që B.G. të cilin e ka kojshi, të ketë marrë letërnjoftimin e tij, pasi që në atë kohë shpesh atij ia ka dhënë në shfrytëzim veturën e tij, ku në atë veturë ka pasur dokumentet e tij personale. Ndërsa në fund thekson se, ai asnjëherë nuk ka nënshkruar para ndonjë zyrtari të Fincës lidhur me ndonjë kredi.

Nga dëshmia e dëshmitarit J.H. gjykata ka vërtetuar se i njëjti në Finca gjatë viteve 2006/07, asnjëherë nuk ka aplikuar për të marrë ndonjë kredi dhe asnjëherë nuk kishte nënshkruar para ndonjë zyrtari të Fincës lidhur me ndonjë kredie, dhe gjatë kësaj kohe nga ai askush nuk ka kërkuar

letërnjoftimin e tij për marrjen e ndonjë kredi në Finca. Në shtëpinë e tij kishin shkuar tre persona, njëri prej të cilëve ishte prezantuar si drejtor i “Fincës”, ku i kishte thënë se ai ka një kredi prej 350 eurove, dhe këtë kredi duhet të e paguajë dhe pastaj përsëri mundet të aplikon, por me atë rast atyre i ka thënë se këtë kredi ai nuk e kishte marrë në Finca, por ka pasur mundësi që B.G. të cilin e ka komshi, të ketë marrë letërnjoftimin e tij, pasi që në atë kohë shpesh atij ia ka dhënë në shfrytëzim veturën e tij, ku në atë veturë ka pasur dokumentet e tij personale

Nga dëgjimi i dëshmitarit A.A. , të dhënë në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se gjatë vitit 2006 letërnjoftimin e saj ja kishte dhënë S.G.(të cilin e kanë mik), për të marrë një kredi në Finca. Një ditë së bashku me bashkëshortin e saj kanë shkuar në dyqanin e djalit të vëllait të S.G. – B.G. i cili gjendet tek “Qalhani”, ku në atë vend kishin qenë edhe disa persona të tjerë të cilët nuk i ka njohur, kanë pritur deri sa në dyqan kanë ardhur V.K. dhe A.V., i kanë dhënë nënshkrimet e tyre dhe për këtë rast nuk din se sa para i ka marrë S.G. për kredin e kërkuar. Në vazhdim thekson se të akuzuarit gjatë nënshkrimit nuk kishin biseduar fare me dëshmitaren, duke mos njoftuar se për çka janë duke nënshkruar dhe se janë të obliguar që në rast të mos kthimit të kredisë nga S.G. , të njëjtit janë të obliguar të e kthejnë Fincës, ndërsa pas një kohë zyrtarët e Fincas kanë ardhur në shtëpinë e tyre lidhur me kredinë, por të njëjtën e kanë mohuar se e kanë marrë për veti.

Nga dëshmia e dëshmitares A.A. gjykata ka vërtetuar se gjatë vitit 2006 letërnjoftimin e saj ja kishte dhënë S.G. (të cilin e kanë mik), për të marrë një kredi në Finca. Dëshmitarja së bashku me bashkëshortin e saj kishin shkuar në dyqanin e djalit të vëllait të S.G. – B.G. i cili gjendet tek “Qalhani”, ku kishin qenë edhe disa persona të tjerë të cilët nuk i ka njohur, kanë pritur deri sa në dyqan kanë ardhur V.K. dhe A.V. , i kanë dhënë nënshkrimet e tyre dhe për këtë rast nuk din se sa para i ka marrë S.G. për kredin e kërkuar. Gjatë nënshkrimit të akuzuarit nuk kishin biseduar fare me dëshmitaren, nuk i kanë njoftuar se për çka janë duke nënshkruar dhe se janë të obliguar që në rast të mos kthimit të kredisë nga S.G. të njëjtit janë të obliguar të e kthejnë Fincës, ndërsa pas një kohë zyrtarët e Fincas kanë shkuar në shtëpinë e tyre lidhur me kredinë, por të njëjtën e kanë mohuar se e kanë marrë për veti

Dëshmitari A.A.1 në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se në institucionin bankar Finca personalisht asnjëherë nuk ka marrë kredi, ndërsa të akuzuarit A.V. dhe V.K. i njeh që nga koha kur S.G. kishte marrë kredi. Më tutje ka shtuar se viti nuk i kujtohet saktë, por se një ditë me bashkëshortin e tij kanë shkuar në dyqan të B.G. e cila gjendet në Qyran, dhe aty brenda kanë qenë A. V. me V.K., të cilët për kredinë e S.G., së bashku me gruan e tij ja kishin dhënë disa dokumente për të nënshkruar, të cilët nuk kanë treguar asgjë se për çka janë duke nënshkruar dhe se në rast të mos kthimit të kredisë nga S.G. janë të obliguar të e kthejnë në vend të tij, pasi që ka menduar se këto po i nënshkruan si dëshmitarë dhe jo si garantues. Pas një kohe zyrtarët e bankës Finca kanë qenë në shtëpinë e tij dhe atij i kanë prezentuar disa dokumente ku ka qenë nënshkrimi me dy shkronja “A dhe Z”, por të cilat nuk kanë korresponduar me nënshkrim e tij të dhënë me të gjitha shkronja si dhe adresa e shtëpisë në ato dokumente ka qenë e shënuar gabimisht ku në vend të “Zarës” ishte shënuar rruga “Edit Durham”. Dhe në fund thekson se “Finca”, asnjëherë nuk e kishte kërkuar kthimin e kredisë të cilën e kishte marrë S.G. , edhe pse nuk e din se i njëjti në emër të kujt e kishte marrë këtë kredi.

Nga dëshmia e dëshmitarit A.A. gjykata ka vërtetuar se i njëjti personalisht nuk kishte marrë asnjëherë kredi në “Finca”. Dëshmitari të akuzuarit A.V. dhe V.K. i njeh që nga koha kur S.G. kishte marrë kredi, kur dëshmitari me bashkëshortin e tij kishin shkuar në dyqan të B.G. aty brenda kanë qenë A.V. me V.K., të cilët për kredinë e S.G. , dëshmitarit dhe gruas se tij ja kishin dhënë disa dokumente për të nënshkruar, nuk i kishin treguar asgjë se për çka janë duke nënshkruar dhe se në rast të mos kthimit të kredisë nga S.G. janë të obliguar të e kthejnë në vend të tij, pasi që ka menduar se

këto po i nënshkruan si dëshmitarë dhe jo si garantues. Pas një kohe zyrtarët e bankës Finca kishin shkuar në shtëpinë e tij dhe i kane prezentuar disa dokumente ku ka qenë nënshkrimi me dy shkronja “A dhe Z”, por të cilat nuk kanë korresponduar me nënshkrimin e tij të dhënë me të gjitha shkronjat si dhe adresa e shtëpisë në ato dokumente ka qenë e shënuar gabimisht ku në vend të “Zarës” ishte shënuar rruga “Edit Durham”. “Finca” asnjëherë nuk e kishte kërkuar kthimin e kredisë të cilën e kishte marrë S.G. , edhe pse nuk e din se i njëjti në emër të kujt e kishte marrë këtë kredi

Nga dëgjimi i dëshmitarit A.B.1 , i cili në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se në Finca personalisht asnjëherë nuk ka marrë asnjëherë kredi, mirëpo daja i tij I.G. para 9-10 vite i kishte kërkuar që të jetë garantues për një kredi në bankën Finca, pasi që i nevojiteshin për me ndërtua murin në shtëpi. Në ditën kritike, me kërkesën e dajës I.G. kishte shkuar në dyqanin e B.G. i cili gjendet tek “Qylhani”, ku aty prezent ka qenë daja i tij I.G. , B.G. dhe e akuzuara V.K., e cila gjatë asaj kohe sa kishte qenë aty nuk kishte folur asgjë, dhe në moment nga ai kanë kërkuar që të nënshkruaj, por pasi që nuk ka ditur shkrim e lexim, nga ai kanë marrë letërnjoftim, por se çka ka ndodhur më vonë nuk njohuri, dhe nga ai rast më zyrtarët e bankës Finca nuk e kanë kontaktuar.

Nga deshmia e dëshmitarit A.B.1 gjykata ka vërtetuar se i njëjti në Finca personalisht asnjëherë nuk ka marrë kredi, mirëpo daja i tij I.G. para 9-10 vite i kishte kërkuar që të jetë garantues për një kredi në bankën Finca, pasi që i nevojiteshin për me ndërtu murin në shtëpi, me kërkesën e dajës I.G. kishte shkuar në dyqanin e B.G. i cili gjendet tek Qylhani, ku aty prezent ka qenë daja i tij I.G. , B.G. dhe e akuzuara V.K., e cila gjatë asaj kohe sa kishte qenë aty nuk kishte folur asgjë, dhe në moment nga dëshmitari kanë kërkuar që të nënshkruaj, por pasi që nuk ka ditur shkrim e lexim, nga ai kanë marrë letërnjoftim, por se çka ka ndodhur më vonë nuk njohuri, dhe nga ai rast më zyrtarët e bankës Finca nuk e kanë kontaktuar.

Dëshmitari K.G. , në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se në Institucionin mikrofinanciar “Finca”, kredi deri në vitin 2007 nuk ka marrë, mirëpo i kujtohet që letërnjoftimin e tij ja kishte dhënë axhës I.G. (tani të ndjerë), i cili ja kishte kërkuar për të marrë një kredi në shumën prej 3000-4000 euro që i nevojiteshin për dasmë, i cili i kishte thënë se po i duhen edhe 5-6 letërnjoftime për me marrë një kredi në shumën më të madhe. Në vazhdim ka theksuar se në ditën kur i kishte dhënë letërnjoftimin I.G. , ka shkuar në një dyqan te Qylhani, ku ka nënshkruar një letër se ishte bërë kredia në shumën prej 3000-4000 eurove për axhën e tij I.G. , të cilën letër (dokument) ja kishin dhënë të akuzuarit A.V. dhe V.K. , të cilët i kishin thënë se duhet të nënshkruan këtë letër pasi që është aprovuar kredia, ndërsa pas nënshkrimit axha I.G. e kishte marrë kredinë. Ndërsa, pas 3 viteve, Finca kishte kërkuar nga ai që kredinë të cilin e kishte marrë axha i tij Ismet duhet ta kthejë, mirëpo për këtë ishte i bindur se këtë kredi Ismeti e kishte kthyer në tërësi, andaj për këtë rast ka shkuar në polici, për ta paraqitur rastin se si ka mundësi që Finca edhe një herë me ardh me kërku kredinë.

Nga dëgjimi i dëshmitarit K.G., gjykata ka vërtetuar se i njëjti nuk ka marrë kredi në Institucionin mikrofinanciar Finca, mirëpo letërnjoftimin e tij ja kishte dhënë axhës se tij I.G. (tani i ndjerë), i cili ja kishte kërkuar për të marrë një kredi në shumën prej 3000-4000 euro që i nevojiteshin për dasmë, i kishte thënë se po i duhen edhe 5-6 letërnjoftime për me marrë një kredi në shumën më të madhe. Ditën kur ia kishte dhënë letërnjoftimin I.G. , ka shkuar në një dyqan te Qylhani, ku ka nënshkruar një letër se ishte bërë kredia në shumën prej 3000-4000 eurove për axhën e tij I.G. , letrën (dokumentin) ja kishin dhënë të akuzuarit A.V. dhe V.K. dhe i kishin thënë se duhet të nënshkruan këtë letër pasi që është aprovuar kredia, pas nënshkrimit axha I.G. e kishte marrë kredinë. Pas 3 viteve, Finca kishte kërkuar nga ai që kredinë të cilin e kishte marrë axha i tij I.G. duhet ta kthejë, mirëpo dëshmitari ishte i bindur se këtë kredi I.G. e kishte kthyer në tërësi, andaj për këtë rast ka shkuar në polici, për ta paraqitur rastin se si ka mundësi që “Finca” edhe një herë me ardhë me kërku kredinë

Dëshmitarit A.G.1 , në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se në Finca personalisht por edhe bashkërisht me ndonjë person tjetër asnjëherë nuk ka marrë kredi. Po ashtu gjatë kësaj kohe nuk ka garantuar për ndonjë person që të merr kredi në bankën Finca, ndërsa po ashtu letërnjoftimin e tij nuk e ka dhënë askujt që të shërbehen me të. Gjatë vitit 2007, zyrtarët e Fincës, e kishin njoftuar se në këtë bankë është marrë një kredi në emër të tij, në shumën prej 600-650 euro, ndërsa në dokumentacionin e kredisë ka qenë fotokopja e letërnjoftimit të tij, ndërsa nënshkrimi i tij në këtë dokumentacion nuk ishte i tij, por ishin vetëm të vendosura inicialet me dy shkronja “A.G”, poashtu edhe emri i babait të tij ishte gabim. Prandaj, këtë fakt e kishte mohuar zyrtarëve të bankës, duke i sqaruar që ai nuk ka aplikuar në emër të tij për asnjë për kredi, ndërsa për letërnjoftimin e tij dyshon se e njëjta kishte mbetur në veturën e S.G. , të cilën e kishte harruar në veturë e tij, andaj edhe dyshon se e njëjta atë ditë është fotokopjuar dhe keqpërdorur për kredi. Të akuzuarit A.V. dhe V.K. nuk i njeh, ndërsa të akuzuarin B.K. e njeh qysh nga koha kur ka qenë i ri.

Nga dëgjimi i dëshmitarit A.G.1 në gjykata ka vërtetuar se i njëjti në “Finca” nuk ka marrë kredi asnjëherë, as personalisht por as edhe bashkërisht me ndonjë person tjetër as qe ka garantuar për ndonjë person që të merr kredi në bankën Finca, gjithashtu letërnjoftimin e tij nuk ia kishte dhënë askujt që të shërbehen me të. Gjatë vitit 2007, zyrtarët e Fincës, e kishin njoftuar se në këtë bankë është marrë një kredi në emër të tij, në shumën prej 600-650 euro, ndërsa në dokumentacionin e kredisë ka qenë fotokopja e letërnjoftimit të tij, ndërsa nënshkrimi i tij në këtë dokumentacion nuk ishte i tij, por ishin vetëm të vendosura inicialet me dy shkronja “A.G”, po ashtu edhe emri i babait të tij ishte gabim, prandaj dëshmitari e kishte mohuar para zyrtarëve të bankës se ka marrë kredi, duke i sqaruar që ai nuk ka aplikuar në emër të tij për asnjë për kredi, ndërsa për letërnjoftimin e tij dëshmitari ka dyshuar se letërnjoftimi i kishte mbetur në veturën e S.G. , ku e kishte harruar në veturë e tij, andaj edhe dyshon se është fotokopjuar dhe keqpërdorur për kredi. Të akuzuarit A.V. dhe V.K. nuk i ka njohur, ndërsa të akuzuarin B.K. e njohte qysh nga koha kur ka qenë i ri.

Dëshmitarit S.M.1 , në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se ai personalisht kredi në Finca nuk ka marrë, ndërsa i kujtohet që 4-5 herë letërnjoftimin e tij B.G.3 ja kishte kërkuar për me marrë ndihma, por ai personalisht e kishte refuzuar që ta jep, mirëpo letërnjoftimin e tij ja kishte dhënë nëna e tij, pasi që B.G.3 e kishte mashtruar duke ja dhënë asaj 20 euro si ndihmë. Thekson se gjatë asaj kohe zyrtarët e Fincas nuk i kishin kërkuar kthimin e kredisë, ndërsa nga fjalët që kishin qarkulluar ka kuptuar se B.G.3 kishte marrë kredi.

Nga dëgjimi i dëshmitarit S.M.1 , gjykata ka vërtetuar se i njëjti kredi në Finca nuk ka marrë, ndërsa B.G.3 ja kishte kërkuar 4-5 herë letërnjoftimin e tij për me marrë ndihma, por nuk ia kishte dhënë, mirëpo nëna e tij ja kishte dhënë letërnjoftimin e tij, pasi që B.G.3 e kishte mashtruar duke ja dhënë asaj 20 euro si ndihmë, ndërsa nga fjalët që kishin qarkulluar ka kuptuar se B.G.3 kishte marrë kredi.

Dëshmitarit G.K. , në shqyrtimin kryesor ka deklaruar deri në vitin 2007, në Finca personalisht nuk ka marrë kredi në emër të tij, mirëpo në emër të tij B.G.3 kishte marrë kredi. Këtë fakt i njëjti e kishte vërtetuar pasi që kishte shkuar në Procreditbank për të marrë një kredi, dhe aty ka kuptuar se në Finca është një kredi në emër të tij. Në atë kohë baba i B.G.3 – S.G. , i cili ka qenë edhe udhëheqës – kryetar i partisë së Ashkalive, i ka marrë letërnjoftimit, që tua jepte librezat e partisë. Më tutje shton se zyrtarët e Fincas, në atë kohë kanë qenë në shtëpinë e tij dhe të njëjtit e kishin njoftuar se është një kredi në shumën prej 2200 eurove, e cila ishte marrë në emër të tij, mirëpo këtë kredi e kishte mohuar tërësisht pasi që ai personalisht atë nuk e ka marrë dhe në dokumentacion tyre nuk figuronte nënshkrimi i tij. Të akuzuarit nuk i njeh, ndërsa me B.G.3 , pas këtij rasti më nuk është takuar ngase i njëjti nuk gjendet në Kosovë.

Nga dëgjimi i dëshmitarit G.K. , gjykata ka vërtetuar se dëshmitari personalisht nuk ka marrë kredi në emër të tij deri në vitin 2007 në Finca, mirëpo B.G.3 kishte marrë kredi në emër të tij, dëshmitari kete e kishte vërtetuar pasi që kishte shkuar në Procreditbank për të marrë një kredi, dhe aty ka kuptuar se në Finca është një kredi në emër të tij. Në atë kohë babi i B.G.3 – S.G. , i cili ka qenë edhe udhëheqës – kryetar i partisë së Ashkalive, i kishte marrë letërnjoftimit, që tua jepte librezat e partisë. Zyrtarët e Fincas, kishin shkuar në shtëpinë e tij dhe e kishin njoftuar se ishte marrë një kredi në shumën prej 2200 eurove në emër të tij, mirëpo këtë kredi e kishte mohuar tërësisht pasi që ai personalisht atë nuk e ka marrë dhe në dokumentacion tyre nuk figuronte nënshkrimi i tij. Dëshmitari të akuzuarit nuk i njihje, ndërsa me B.G.3 , pas këtij rasti më nuk është takuar ngase i njëjti nuk gjendet në Kosovë.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit S.M.2 të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë të dt. 07.04.2009, ka vërtetuar se i njëjti në Finca ka ardhur me 01.12.2006, ndërsa si drejtor gjeneral prej datës 01.Gusht 2007. Gjatë vitit 2007 në këtë Institucionin mikrofinanciar “Finca” në Prizren, ka pasur një auditim të brendshëm dhe gjatë hulumtimit të tyre janë vërejtur disa parregullsi të cilat janë ndërlidhur me punën e A.V. dhe V.K. . I akuzuari A.V. në Finca ka qenë në pozitën e udhëheqësit në degën e Malishevës-Rahovec, ndërsa e akuzuara V.K. ka qenë në pozitën e nëpunëses seniore për dhënien e kredive në të ashtuquajtura grupe fshatare, e cila ka raportuar A.V. , ndërsa A.v. ka raportuar menaxhmentit më të lart. Më tutje ka shtuar se në bazë të hulumtimeve dy ish bashkëpunëtorët A.V. dhe V.K. , në bashkëpunim me klientë të jashtëm, gjegjësisht 3 vëllezërit G. kanë bashkëpunuar dhe në mënyra të ndryshme kanë bërë mashtrime. Aktiviteti i tyre ka qenë i atillë që nëpunësi kreditor ka raportua udhëheqësit të filialës së dhe në bashkëpunim me të tjerët kanë bërë mashtrim. Dokumentet çdo herë janë prezantuar në komitet të kredive, kjo do të thotë që oficeri për kredi (V.K.) e tregon rastin para komitetit për kredi (A.V.), dhe aty pastaj shqyrtohen çështja, në bazë të dokumentacionit, pra e akuzuara V.K. ka dorëzuar dokumentacion para komitetit dhe komiteti i ka marrë se ato janë të sakta të vërteta në bazë të cilave ka vendosur. Ndërkaq, A.V. ka qenë kontrollues i propozimeve të kredive nga V.K. , ai ka pasur mundësi që të mos pranojë ato dokumente në atë mënyrë, pra si udhëheqës i filialës Antoni ka qenë përgjegjës për kontrollimin e dokumenteve të paraqitura dhe saktësinë e tyre. Më tutje shton se nga rezultatet e auditimit kanë treguar se në njërin anë janë përdorur dokumente të falsifikuara dhe se kredit janë aplikuar për një qëllim tjetër, d.m.th. janë krijuar grupe të cilat kanë bërë kërkesë për kredi dhe këto kredi pastaj janë përcjellë te ashtuquajturit 3 vëllezërit G. , ndërsa aplikuarit për kredi kanë marrë nga 20 euro secili prej tyre. Në vazhdim ka shtuar se kemi të bëjmë me dokumente të cilat nuk janë plotësuar në tërësi, ka dokumente të që janë përdorur letërnjoftime ose karta identiteti pa e ditur pronari i kartës së identitetit dhe se janë bërë të dhëna të falsifikuara lidhur me aftësinë e kthimit të kredisë. Limiti për lejimin e kredive të cilat i rregullonte dokumentacion A.V. ka qenë 2500 euro, dhe për këtë arsye janë angazhuar shumë persona ose janë përdorur emrat e tyre në mënyrë që të tërhiqen shuma çfarë janë tërhequr në emër të kredive nga banka, dhe shuma prej 900.000 është shuma që është tërhequr në emër të personave që janë shënuar si dëmtuar apo dëshmitarë në këtë çështje penale.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitares D.K. të dhënë para PTH-së në Prizren të dt. 03.04.2008, ka deklaruar se në Institucionin mikrofinanciar “Finca” në Prizren, ka ardhur në pozitën e shefit të zyrës operative, dhe në atë kohë nga ana e avokatit dhe menaxherit është njoftuar se një kallëzim penale është transferuar në prokurori, për bashkë keqpërdorim të detyrës nga ana e A.V. dhe V.K. , të cilët së bashku me një familje G. kanë dëmtuar interesat e institucionit. Në vazhdim ka shtuar se procedurat për të marrë kredi në Finca, duhet të kalohet në procedurat e parapara me normativën e cila është pjesë e punës, procedurat duhet të respektohen nga ana e secilit klientë, dhe të i nënshtrohen shërbimit verifikues, se a i plotëson kushtet për kredi apo jo, bëhet verifikimi i biznesit të cilën e ushtron dhe

vendoset në komitet i cili është funksional në kuadër të institucionit, gjithnjë duke kaluar në procedurë të parapamë.

Nga dëshmia e dëshmitares D.K. gjykata ka vërtetuar se si janë zhvilluar procedurat për marrjen e kredisë në Finca, ku këto procedura kanë qenë asi soji që procedurat duhet të respektohen nga ana e secilit klientë, dhe të i nënshtrohen shërbimit verifikues, se a i plotëson kushtet për kredi apo jo, bëhet verifikimi i biznesit të cilën e ushtron dhe vendoset në komitet i cili është funksional në kuadër të institucionit, gjithnjë duke kaluar në procedurë të parapamë.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitares A.V.1 , e cila në deklaratën e saj ka deklaruar se ngel në tërësi si në deklaratën e saj të dhënë me datë 29.12.2010, ku ndër të tjera ka theksuar se në Finca ka punuar nga viti 2000 deri më 16 Tetor 2007, si udhëheqëse e financave, dhe nga dëshmia e saj gjykata ka vërtetuar se në Finca kredit grupore jepeshin në atë mënyrë që duhet të formohej grupi, të cilët ishin solidar në mes veti, garantonin për njëri tjetrin, vlerat e kredive ishin maksimalisht 2000-3000, mirëpo nëse këto vlera përsëriteshin prej të njëjtit grup ato rriteshin. Sipas rregullit në këtë institucion nuk ka qenë e lejuar që një anëtar i grupit të merr të hollat për tërë grupin, por secili ka mundur të tërheq parat vetë, nënshkrimi i kontratës në bazë të aplikimit për kredit të grupit është bërë para mbikëqyrësit drejt për drejt. Nga ana e bankës ishte edhe mbikëqyrësi i atij grupi dhe kontrata e kredisë duhej të nënshkruhej para këtij mbikëqyrësi, si dhe tërheqja e atyre të hollave është bërë në mbikëqyrjen e personit të autorizuar. Roli udhëheqësit të kreditit grupor ka qenë formimi i grupit dhe përcjellja e tyre se si kthehen krediti, ndërkaq për dhënien e kredive grupore kanë qenë të parapara manuele të cilat kanë përshkruar rregullat në hollësisht. Më tej ka shtuar se shpërndarja e kredive grupore jashtë zyrave, ka qenë e mundur deri sa Finca nuk ka pasur zyre të autorizuar në teren, dhe personat e autorizuar, gjegjësisht mbikëqyrësit kanë dorëzuar klientëve drejt për drejt jashtë zyrës të hollat, ndërsa me hapjen e zyrave këto raste janë eliminuar, atëherë obligimi i dhënies së kredive ishte ekskluzivisht në zyre, pra dorëzimi i kredive në bazë të kontratës së lidhur me personat e theksuar në kontratë.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit A.G.4 të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë të dt. 05.11.2009, i cili ka deklaruar se S.G. e ka komshi, i njëjti ishte paraqitur me kërkesë se dëshiron të merr një kredi në “Finca”, por se i duhet letërnjoftimi i tij, të cilin edhe ja kishte dhënë. Më tutje ka shtuar se pas 2 dite në dyqanin e Rr.G. ka nënshkruar kontratën për kredi, duke ditur që kjo kontratë për kredi është për S.G. , andaj edhe të njëjtën nuk e ka shikuar. Në ditën kur ka nënshkruar kontratën kanë qenë prezentë edhe të akuzuarit A.V. dhe V.K. , me të cilët nuk ka biseduar asgjë, pasi që ka konsideruar se po nënshkruan kontratën e kredisë për S.G. , pas nënshkrimit të kontratës S.G. i kishte dhënë 20 euro për të pirë një kafe.

Nga dëshmia e dëshmitarit A.G.4 gjykata ka vërtetuar se i njëjti S.G. e ka komshi, i njëjti ia kishte kërkuar letërnjoftimin e tij për të marr një kredi në Finca, të cilin edhe ja kishte dhënë, ndërsa pas 2 dite në dyqanin e Rr.G. e kishte nënshkruar kontratën për kredinë e S.G. , te cilën nuk e ka shikuar fare, prezentë kane qene edhe të akuzuarit A.V. dhe V.K., me të cilët nuk ka biseduar asgjë, pasi që ka konsideruar se po nënshkruan kontratën e kredisë për S.G. i cili pas nënshkrimit të kontratës ia kishte dhënë 20 euro për të pirë një kafe.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit A.G.3 të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 05.11.2009, i cili ka deklaruar se ka nënshkruar një kredi prej 2000 euro në interes të B.G. , nuk e din se a ka qenë garantues apo dëshmitarë, pasi që nuk e ka shikuar kontratën se çka po shkruan aty, ndërsa kur e ka nënshkruar këtë në prezencë të V.K. nuk ka biseduar për kredi. Më tutje ka shtuar se për këtë nënshkrim B.G. nuk i ka dhënë asgjë, përndryshe tek ai ka qenë i punësuar në dyqanin e tij si punëtor, ndërsa disa herë B.G. i kishte dhënë të holla që ti kryejë pagesat e kredive të ndryshme.

Nga dëshmia e dëshmitarit A.G.3 gjykata ka vërtetuar se i njëjti ka nënshkruar një kredi prej 2000 euro në interes të B.G. , duke mos e ditur se a ka qenë garantues apo dëshmitarë, kontratën e ka nënshkruar duke mos e shikuar se çka po shkruan aty në prezencë të V.K.e cila nuk ka biseduar për kredi, B.G. nuk i kishte dhënë asgjë, përndryshe tek ai ka qenë i punësuar në dyqanin e tij si punëtor, ndërsa disa herë B.G. i kishte dhënë të holla që ti kryejë pagesat e kredive të ndryshme

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit B.K., të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 22.10.2010, i cili ka deklaruar se S.G. ka kërkuar që të bëhet dëshmitarë për një kredi në bankën Finca, dhe për këtë i ka dhënë 20 euro bakshish. Pas kësaj në bankën në Rahovec ka nënshkruar disa letra, ku ishte edhe A.V. . Gjithashtu ka shtuar se edhe B.G.3 e ka lutur me u bë dëshmitarë në prezencën e A.V., ku kanë shkruar në shtëpinë e tij dhe i kanë kërkuar letërnjoftimin për me mare një kredit dhe për këtë ka gjetur edhe 6-7 persona të fshatit të tij, ndërsa A.V. me atë rast i ka thënë “mos frikoi ndihmoni njëri tjetrin”, për këto nënshkrime nuk ju është thënë se po e ngarkojnë veten me kredi, ndërsa për nënshkrime i kanë marrë nga 20 euro. Me tutje ka shtuar se personalisht A.V. i ka dhënë nga 20 euro, po ashtu edhe A.H. , B.H. , S.H. , N.H. , Y.H. dhe dy personave të tjetër të cilëve nuk po i kujtohet emri. Ndërsa në fund ka shtuar se A.V. e njeh mirë pasi që i njëjti disa herë ka ardhur në shtëpinë e tij, ku aty janë tubuar edhe personat e tjerë dhe B.G.3 e B.G., të cilët kanë marrë kredi nga 3 herë përmes tij në këtë mënyrë.

Nga dëshmia e dëshmitarit B.K. gjykata ka vërtetuar se S.G. i kishte kërkuar që të bëhet dëshmitarë për një kredi në bankën Finca, dhe për këtë ia ka dhënë 20 euro bakshish, në bankën në Rahovec ku ishte edhe A.V. dëshmitari kishte nënshkruar disa letra. Edhe B.G.3 e kishte lutur me u bë dëshmitarë në prezencën e A.V.v , për çka kanë shkruar në shtëpinë e tij dhe i kanë kërkuar letërnjoftimin për kredi dhe për këtë ka gjetur edhe 6-7 persona të fshatit të tij, A.V. me atë rast i kishte thënë “mos frikoi ndihmoni njëri tjetrin”, për këto nënshkrime nuk ju është thënë se po e ngarkojnë veten me kredi, ndërsa për nënshkrime i kanë marrë nga 20 euro, edhe A.V. personalisht ia kishte dhënë nga 20 euro, po ashtu edhe A.H. , B.H. , S.H. , N.H. , Y.H. dhe dy personave të tjetër emrat e të cilëve nuk i kujtoheshin, dëshmitari A.V. e ka njohur mirë pasi që i njëjti disa herë kishte shkruar në shtëpinë e tij, ku aty janë tubuar edhe personat e tjerë edhe B.G.3 e B.G., të cilët kishin marrë kredi nga 3 herë përmes tij në këtë mënyrë.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit F.D.1 , të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 22.10.2010, i cili ka deklaruar se personalisht B.G.3 dhe B.G. kanë ardhur nëpër lagjen e tyre duke i mbledhur letërnjoftimet e personave të ndryshëm që ti i përdorin si dëshmitarë për kredi në emër të tyre, ndërsa prej anëtarëve të familjes së tij letërnjoftimet i janë marrë H.D. , H.D.1 , dhe N.D. . Në vazhdim ka theksuar se në kohë sa ka punuar në dyqanin e B.G.3 në hekurishte, A.V. dhe V.K. në çdo mëngjes kanë qenë aty, ku të njëjti në shumë raste e kanë larguar nga shitorja dhe kanë biseduar nga brenda. Po ashtu në atë dyqan kanë ardhur shumë persona të panjohur dhe kanë marrë kredi, të cilat i ka shpërndarë A.V..

Nga dëshmia e dëshmitarit F.D.1 gjykata ka vërtetuar se B.G.3 dhe B.G. kanë shkruar nëpër lagjen e tyre dhe i kanë mbledhur letërnjoftimet e personave të ndryshëm që ti i përdorin si dëshmitarë për kredi në emër të tyre, ndërsa prej anëtarëve të familjes së tij letërnjoftimet i janë marrë H.D. , H. D.1, dhe N.D. . Dëshmitari kishte punuar në dyqanin e B.G.1 në hekurishte dhe gjate asaj kohe, A.V. dhe V.K. në çdo mëngjes kanë qenë aty, ku të njëjti në shumë raste e kanë larguar nga shitorja dhe kanë biseduar brenda dhe se në atë dyqan kishin ardhur shumë persona të panjohur dhe kanë marrë kredi, të cilat i ka shpërndarë A.V..

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitares A.H. , të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 04.11.2010, e cila ka deklaruar se A.V. dhe V.K. i njeh dhe atë përmes S.G. i cili jeton në Beograd, këtë të tre kanë

qenë shtëpinë e tyre në Rahovec. Më tej ka shtuar se Sadiku si kushëri ka ardhur në shtëpi e tyre dhe ka kërkuar njerëz për të marrë kredi, duke iu thënë se është klient i rregullt i Fincës që 10 vite, ka shtëpi dhe dyqane në Prizren, diku ju thënë se edhe ju keni me ja pa hajrin, ndërkaq për këtë i ka kërkuar të gjithëve letërnjoftimet me i fotokopjuar për të marrë kredi në emër të tyre por kredinë S.G. e merrte për vete, dhe pas dorëzimit të letërnjoftimeve S.G. të gjithëve ju ka dhënë nga 20 euro. Në vazhdim ka theksuar se S.G. poashtu ka ardhur në shtëpi dhe me automjetin e tij ka dërguar në bankën Finca për të dhënë nga një nënshkrim, ndërsa letërnjoftimet i ka kthyer. Gjatë nënshkrimit A.V. me S.G. kanë qenë prezent të cilët kanë thënë vetëm nënshkruajë në këtë vend.

Nga dëshmia e dëshmitares A.H. , gjykata ka vertetuar se te akuzuarit A.G. dhe V.K. i ka njohur përmes S.G. i cili jeton në Beograd, këtë të tre kanë qenë shtëpinë e tyre në Rahovec. S.G. si kushëri i tyre kishte shkuar në shtëpi e tyre dhe ka kërkuar njerëz për të marrë kredi, duke iu thënë se është klient i rregullt i Fincës që 10 vite, ka shtëpi dhe dyqane në Prizren, diku ju thënë se edhe ju keni me ja pa hajrin, ndërkaq për këtë iu ka kërkuar të gjithëve letërnjoftimet me i fotokopju për të marrë kredi në emër të tyre por kredinë S.G. e merrte për vete, dhe pas dorëzimit të letërnjoftimeve S.G. të gjithëve ju ka dhënë nga 20 euro, S.G. kishte shkuar në shtëpinë e tyre i kishte marre dhe me automjetin e tij i ka dërguar në bankën Finca për të dhënë nga një nënshkrim, ndërsa letërnjoftimet ia ka kthyer, gjatë nënshkrimit A.V. me S.G. kanë qenë prezent dhe iu kanë treguar se ku duhet të nënshkruajnë.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit B.G.2 , të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 04.11.2010, i cili ka deklaruar se B.G.3 e njeh, është dhëndër i kojshive të tij në Lipjan, në vitin 2007 në pranverë, me te ishte takuar në treg ku i kishte kërkuar ndihmë për t'ia gjetur disa letërnjoftime, për të marrë një kredi në bankë në shumën prej 1000 eurove, pasi që një fëmijë e kishte të sëmurë dhe dëshironte që ta dërgonte në shërim jashtë vendit. Më tutje ka shtuar në atë momente, B.G.3 , fëminë e kishte me vete i cili ishte në gjendje shumë të keqe, ishte i palëvizshëm, dhe në atë moment ia ka dhënë letërnjoftimin e tij dhe të shoqes së tij. Pas një kohe, B.G.3 i ka ardhur përsëri në shtëpi dhe ka kërkuar edhe disa letërnjoftime të tjera, duke i thënë se nuk po mundet të kryejë punë vetëm me këta dy letërnjoftime, kinse janë të ri e banka nuk po i beson atyre, andaj pas ka shkuar te halla e tij në fshatin Hallaq i Vogël, ku i ka marrë edhe disa letërnjoftime të tjera, ku gjithsej B.G.3 i ka dorëzuar 8 letërnjoftime. Gjatë vitit 2008, burri i hallës së tij B.B. ka dashur të merr një kredi në “Pro Credit” në Lipjan, mirëpo banka nuk ja kishte dhënë kreditin, pasi që emri i tij ishte duke figuruar si borxhli në bankën Finca, dhe me atë rast së bashku me B.B. kishin ardhur në Prizren për me e taku B.G.3 se si është puna e borxhit në Finca, ku edhe ishin takuar me B.G.3 në shtëpinë e tij ku më vonë kishte ardhur edhe A.V. , të njëjtit janë arsyetuar se është bërë një mosmarrëveshjes. Pas insistimit të B.B., për ta liruar nga kredia A.V. i dha 1500 euro, dhe pas kësaj edhe janë marrë vesh që vinë në Prizren edhe borxhin e tij dhe të B.B. me e shly në Finca. Në vazhdim dëshmitari ka shtuar se të hënë edhe pse erdhën në Prizren, me A.V. nuk mundën me kontakt, pasi që ishte i sëmurë, dhe me atë rast B.G.3 i dërgoi në Malishevë ku atje ishte edhe një filialë e Fincës. Në Malishevë, kanë hyrë me një dyqan dhe në kat i ka pritur e akuzuara V.K. dhe me atë rast ajo i ka dhënë disa dokumente për të nënshkruara dhe pas kësaj ka thënë se më nuk do të keni borxhe në Finca. Në fund thekson se në gjykatën e Lipjanit është paditur nga Finca për borxhin në shumën prej 8000 euro në emër të kredisë.

Nga dëshmia e dëshmitarit B.G.2 gjykata ka vertetuar se dëshmitari e njohte B.G.3 si dhëndër i kojshive të tij në Lipjan, me te ishte takuar në treg në vitin 2007 në pranverë ku i kishte kërkuar ndihmë për t'ia gjetur disa letërnjoftime, për të marrë një kredi në bankë në shumën prej 1000 eurove, pasi që një fëmijë e kishte të sëmurë dhe dëshironte që ta dërgonte në shërim jashtë vendit. B.G.3 fëmiun e kishte me vete dhe ishte në gjendje shumë të keqe, ishte i palëvizshëm, në atë moment ia ka dhënë letërnjoftimin e tij dhe të shoqes së tij. Pas një kohe, B.G.3 i kishte shkuar përsëri në shtëpi dhe ka kërkuar edhe disa letërnjoftime të tjera, duke i thënë se nuk po mundet të kryejë punë vetëm me

këta dy letërnjoftime, kinse janë të ri e banka nuk po i beson atyre, andaj me pas ka shkuar te halla e tij në fshatin , ku i ka marrë edhe 8 letërnjoftime dhe ia ka dhene B.G.3 . Gjatë vitit 2008, burri i hallës së tij B.B. ka dashur të merr një kredi në “Pro Credit” në Lipjan, mirëpo banka nuk ja kishte dhënë kreditin, pasi që emri i tij ishte duke figuruar si borxhli në bankën Finca, dhe me atë rast së bashku me B.B. kishin ardhur në Prizren për me e taku B.G.3 se si është puna e borxhit në Finca, ku edhe ishin takuar me B.G.3 në shtëpinë e tij ku më vonë kishte ardhur edhe A.V. , të njëjtit janë arsyetuar se është bërë një mosmarrëveshjes. Pas insistimit të B.B. , për ta liruar nga kredia A.V. ia ka dhene 1500 euro, dhe pas kësaj edhe janë marrë vesh që te vijnë në Prizren edhe borxhin e tij dhe të B.B. me e shly në Finca, mirëpo edhe pse kane shkuar në Prizren, nuk kane mundur te kontaktojnë me A.V. pasi që ishte i sëmurë mirëpo B.G.3 i kishte dërguar në Malishevë ku ne një dyqan i kishte prituar e akuzuara V.K. iu kishte dhënë disa dokumente për të nënshkruara dhe pas kësaj iu kishte thënë se më nuk do të keni borxhe në Finca, ndërsa në gjykatën e Lipjanit është paditur nga Finca për borxhin në shumën prej 8000 euro në emër të kredisë.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit A.B. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 22.11.2010, i cili ka deklaruar se në Finca - Malishevë ka marrë një kredi prej 2500 eurove të cilin kredi e ka mundësuar B.G. , për të cilin ka punuar rreth një viti në hekurishte te “Qylhani”. B.G. në atë kohë ka punuar në bankë, kredia prej 2500 eurove është marrë për nevojat e B.G. , pasi që ato para i nevojiteshin B.G. . Në ditën kur ka nënshkruar kredinë në bankën Finca në Malishevë, prezent ka qenë V.K. , e cila në prezencën e tij nuk ka biseduar asgjë. Në vazhdim ka theksuar se pas një kohe zyrtarët e Fincas kanë ardhur te aji në shtëpi dhe se është i ngarkuar me kredi prej 5000 euro. Po ashtu në vazhdim ka potencuar se për llogari të B.G. në Prizren në Finca ka paguar edhe këstet e kredive të cilat i kishte B.G. në këtë bankë. Po ashtu gjatë kësaj kohe B.G. nga ai ka kërkuar që të mbledhë letërnjoftime të disa personave, ndërsa gjatë kohës sa ka punuar tek ai në “Qylhan” të akuzuarit A.V. dhe V.K. kanë ardhur një herë në dyqanin e B.G. .

Gjykata dëshmisë se dëshmitarit A.B. ia fali besimin nga kjo dëshmi është vërtetuar se i njëjti në Finca - Malishevë ka marrë një kredi prej 2500 eurove të cilin kredi ia ka mundësuar B.G. , për të cilin ka punuar rreth një viti në hekurishte te “Qylhani”. kredia prej 2500 eurove është marrë për nevojat e B.G. , ditën kur ka nënshkruar kredinë në bankën Finca në Malishevë, prezent ka qenë V.K. , e cila nuk kishte biseduar asgjë. Pas një kohe zyrtarët e Fincas kishin shkuar në shtëpi e tij dhe e kishin ngarkuar me kredi prej 5000 euro, gjithashtu për llogari të B.G. në Prizren në Finca ka paguar edhe këstet e kredive të cilat i kishte B.G. në këtë bankë, gjatë kësaj kohe B.G. nga ai kishte kërkuar që të mbledhë letërnjoftime të disa personave, ndërsa gjatë kohës sa ka punuar tek ai në “Qylhan” të akuzuarit A.V. dhe V.K. kishin shkuar një herë në dyqanin e B.G. .

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit M.J. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 22.11.2010, i cili ka deklaruar se B.G. e njeh që nga koha kur a punuar në marketin “Kastrati” në Arbanë. Gjatë kësaj kohe në shtëpinë e tij ka pasur renovim dhe për këtë i nevojiteshin 600 euro, ndërsa me B.G., A.G.3 e kishte njoftuar duke i thënë se vetëm B.G. mundet me të nxjerrë kredi. Pas bisedës që kishte pasur me B.G. lidhur me kredinë, i njëjti i kishte kërkuar 4 letërnjoftime, ndërsa pas kësaj të njëjtit ia kishte dhënë letërnjoftimin e babës, nuses, axhës dhe vëllaut të tij. Më tutje thekson se B.G. me një letre të thjeshtë, pa vulë i ka dhënë 600 euro, të cilat pastaj i kishte kthyer në këste me nga 75 euro në muaj, gjegjësisht në shumën prej 986 euro të gjitha pagesat i kishte B.G. në dorë, pa asnjë dokument të bankës. Për kredinë zyrtarët e bankës Finca asnjëherë nuk ai kanë ardhur të kërkojnë borxhin, ndërsa të akuzuarit A.V. dhe V.K. nuk i njeh dhe nuk i ka parë më parë.

Nga dëshmia e dëshmitarit M.J. gjykata ka vërtetuar se dëshmitari B.G. e njeh që nga koha kur ai kishte punuar në marketin “Kastrati” në Arbanë, gjatë kësaj kohe në shtëpinë e tij ka pasur renovim dhe për këtë i nevojiteshin 600 euro, ndërsa me B.G. , AG.3 e kishte njoftuar duke i thënë se

vetëm B.G mundet me të nxjerrë kredi, pas bisedës që kishte pasur me B.G. lidhur me kredinë, i njëjti i kishte kërkuar 4 letërnjoftime, ndërsa pas kësaj të njëjtit ia kishte dhënë letërnjoftimin e babës, nuses, axhës dhe vëllaut të tij. Më tutje thekson se B.G. me një letre të thjeshtë, pa vulë i ka dhënë 600 euro, të cilat pastaj i kishte kthyer në kiste me nga 75 euro në muaj, gjegjësisht në shumën prej 986 euro të gjitha pagesat i kishte bere B.G. në dorë, pa asnjë dokument të bankës, për kredinë zyrtarët e bankës "Finca" asnjëherë nuk i kanë ardhur të kërkojnë borxhin, ndërsa të akuzuarit A.V. dhe V.K.nuk i njihje dhe nuk i kishte parë më parë.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit E.K. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 17.12.2010, e cila ka deklaruar se në Finca është punësuar në vitin 2000 fillimisht si asistente administrative, ndërsa gjatë vitit 2007 ka punuar në vendin e punës si menaxhere e burimeve njerëzore të cilën detyrë e ka ushtruar deri më vitin 2009 ku edhe ka lëshuar punën. Më tutje ka shtuar se në atë kohë ka dëgjuar se A.V. ka pasur një lloj të shkeljeve të procedurave, mirëpo faktet nuk i din, ndërsa gjatë kohës sa ka punuar ka pasur mundësi që të mirën kredit grupore, ku nëpunësi kreditor ka mundur të gjejë klient të formoj një grup të përgatisë të gjitha dokumentet e nevojshme të atij grupi dhe pastaj këto dokumente janë shqyrtuar në zyrën përkatëse se a plotësohen kushtet për aprovimin apo jo të kredisë.

Nga leximi i deklaratave të dhëna nga S.G. nga Prizreni dhe A.G. dhe B.G. nga Prizreni të dhëna me datë 17.08.2007 në Finca – zyra në Prizren, nga përmbajtja e tyre rezulton se S.G. ka marrë për obligim që të paguajë në tërësi Finca/Kosovës shumën prej 429.537,49€, A.G. ka marrë për obligim që të paguajë në tërësi Finca/Kosovës shumën prej 129.719,84€, B.G. ka marrë për obligim që të paguajë në tërësi Finca/Kosovës shumën prej 256.567,30 € të cilat shuma të hollave janë huat e lejuara të disa individëve dhe grupeve kreditore solidare nga ana e Institucionit Mikrofinanciar Finca/Kosova me seli në Prizren, të cilat hua këta persona i kanë shfrytëzuar në tersi.

Nga leximi i raportit të Finca në Prizren raportuar Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës prej Janarit 2006 deri në Dhjetor 2007, gjykata ka vërtetuar se ky Institucioni Mikrofinanciar ka raportuar Autoritetit Qendror Bankar lidhur me shumën e kredive dhe numrin e kredive aktive të cilat janë dhënë grupeve kreditore si dhe gjendjen e portofolios së papaguar për muajin raportues.

Nga leximi i raporteve kuartale të Fincës raportuar Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës për kuartarin Shtator 2007 dhe Dhjetor 2007, gjykata ka vërtetuar bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave të cilat janë raportuar nga Finca lidhur me kushtet e këtij institucioni deri më datën raportuese.

Nga shiqimi i kontratës së punës të ish punëtorëve të Fincës me seli në Prizren, respektivisht për të pandehurit A.V. dhe V. K. dhe përshkrimin e punës së tyre, gjykata ka vërtetuar se të akuzuarit kanë qenë të punësuar tek e dëmtuara Finca që nga viti 2000 në pozita të ndryshme të punës në kohë të pacaktuara pranë këtij Institucioni mikrofinanciar, gjegjësisht A.V. në pozitën e menaxherit të degës në Malishevë, ndërsa V. K. si zyrtare për kredina.

Nga leximi në letrën e paralajmërimit për suspendim nga puna e të akuzuarve Anton Vuçaj dhe Vjollca kabashi, gjykata ka vërtetuar se të akuzuarit ishin liruar nga çdo detyrë në Finca dhe gjatë kohës së hetimeve nga Auditori i Brendshëm të njëjtit janë pezulluar nga detyra me pagesë.

Nga leximi i letrës përfundimtare të pushimit të marrëdhënies së punës për të akuzuarit A.V. dhe V.K. , gjykata ka vërtetuar se nga Drejtori i Fincës S.M.2 , është shkëputur me efekt të menjëhershëm kontrata e punës së akuzuarve në këtë Institucion Mikrofinanciar.

Nga leximi i ekspertizës financiare dhe i aneks ekspertizës të kryer nga eksperti B.I. , gjykata ka vërtetuar se eksperti pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe dokumentacionit shtesë të siguruar nga Institucioni Mikrofinanciar “Finca”, eksperti ka konstatuar se të akuzuarit A.V. , V.K. , M. H. , në cilësinë e personave të autorizuar për dhënien e kredive në grup dhe kredive individuale në Institucionin Mikrofinanciar “Finca”, së bashku me klientët (agjentët) e autorizuar A.G., B.G., S. G., B.G.3 dhe B.K. , në mënyrë të drejtpërdrejt e kanë dëmtuar Institucionin Mikrofinanciar “Finca” në shumën prej 889.637,25 €. Në vazhdim sipas ekspertit personat që kanë formuar grupe apo persona përgjegjës janë të akuzuarit A.G. në total me 93 klient të mashtruar, B.G. në total prej 283 klient të mashtruar, S.G. në total prej 346 klient të mashtruar, ku përsëriten emrat e klientëve të njëjtë në grupe të ndryshme dhe me emërtime të ndryshme. Në mesin e këtyre klientëve janë prezent edhe emrat e dëshmitarëve të dëgjuar në shqyrtimin kryesor. Në vazhdim sipas mendimit të ekspertizës duke u bazuar në Libër-Udhëzues të kredive për Finca dhe në Standardet e Kontabilitetit Ndërkombëtar (SNK), dhe Standardet e Kontabilitetit të Kosovës (SKK), të cilat standarde janë të aplikueshme në Kosovë se përgjegjësia për shpërdorimin e detyrës zyrtare bien jo vetën në personat përgjegjës A.V. dhe V.K. por edhe në menaxhmentin e lartë, të cilët kanë punuar dhe vepruar në atë kohë. Sipas ekspertit përgjegjësia materialo – financiare bien mbi klientët (agjentët) e autorizuar të tyre A.G. me 137.579, 74€, B.G. me 308.028,96€ dhe S.G. me 444.028,55€, por gjithsesi si realizues të kundërligjshëm të mjeteve financiare janë edhe B.G.3 , B.K. dhe M.H., duke e dëmtuar institucion “Finca” në Prizren në shkaktimin e humbjes prej 889.637,25€.

Nga leximi i dëshmisë së dhënë nga eksperti B.I. në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 11.01.2010, i cili ka deklaruar se qëndron në tersi pranë ekspertizës së parashtruar me shkrim, duke theksuar se bazuar në dokumentacionin që i është ofruar nga Finca dhe shkresave të lëndës i akuzuari gjatë periudhës për të cilën është akuzuar ka qenë i sistemuar me punë si menaxher i degës “Finca” për Malishevë, Rahovec dhe pjesë të ndryshme të Prizrenit, i cili ka pasur një vend të punës dhe ka qenë përgjegjës i oficerit kreditues si dhe përcjelljen e punës së tij. Më tutje ka potencuar se në bazë të përshkrimit të vendit të punës, oficeri kreditues në rastin konkret ka pasur për obligim të azhurojë dhe të veprojë në situata të caktuara të raportojë menaxherit të vet për pengesat në pagesën e kredive dhe të parandalon dhënien e kredive më tutje duke i ndërmarrë masat adekuate.

I akuzuri A.V. gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprat penale që i vihen në barre, ndërsa në mbrojtjen e tij ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë deklaratës së dhënë në prokurori dhe në shqyrtimin gjyqësor me dt. 24.01.2011 dhe 22.02.2011. Në vazhdim ka theksuar se në Finca ka filluar të punoj nga muaji prill i viti 2000 deri më gusht të vitit 2007, ndërsa prej muajit dhjetor 2006 e deri më maj të vitit 2007 ka qenë në pozitën e menaxherit të degës në Malishevë, Rahovec dhe për një pjesë të klientëve në Prizren, ndërsa mbikëqyrësi i tij drejtpërdrejtë ka qenë E.P. . Në vazhdim të mbrojtjes së tij ka vazhduar me shpjegimin e procedurat për dhënien e kredive grupe, ku agjenti i kredive ka bërë promovimin e kredive në vendet e ndryshme dhe persona të ndryshme, pas interesimit të personave të ndryshëm është marrë vendim për grupe të caktuar, ku është bërë nga kryetari i grupit, sekretari dhe arkëtari të cilët kanë qenë persona me emër dhe në atë rreth ku kanë jetuar. Pasi që është bërë vizita e bizneseve ata kanë bërë kërkesë për kredi dhe janë formuar të gjitha format e caktuara dhe dokumentacioni i kompletuar nga agjenti debitor është dërguar tek udhëheqësi i tij për aprovim, përveç udhëheqësit personal në formën e aprovimit kanë qenë edhe nënshkrimet e udhëheqësit më të lart dhe të financave, dhe pas aprovimit është bërë disbursimi apo shpërndarja e kredisë për ata persona, ku edhe janë lidhur kontratat në mes të grupit të caktuar dhe Institucionit Finca ku kanë qenë të gjitha emrat e anëtarëve të grupit, ndërsa shpërndarja e mjeteve në shumicën e rasteve ka qenë në teren në një vend të caktuar ku kjo shume i është dhënë kryetarit të grupit i cili pastaj ka shpërndarë këto shuma anëtarëve tjerë të grupit. Këto procedura kanë qenë të pranueshme nga mbikëqyrësi i tij drejtpërdrejtë dhe në formën e aprovimit të huasë ka qenë i domosdoshëm edhe nënshkrimi i mbikëqyrësit më të lart. Më tutje ka theksuar se përgjegjësia e kthimit të kësteve të

kredisë ka qenë e secilit anëtarë në bazë të kështit mujor, ku në fshatra ka qenë e caktuar dita kur përfaqësuesi i Finca-së ka shkuar dhe i ka grumbulluar kistet nga anëtarët, ndërsa në Finca kistet i ka paguar një përfaqësues i grupit. Qëllimi i kredive grupore ka qenë ndihma e bizneseve të cilët nuk kanë pasur akses në bankat komerciale dhe për këto kredi nuk është kërkuar peng, e vetmja garancë që është kërkuar ka qenë garantimi solidar nga vet grupi. Më tutje ka theksuar se në pozitën që ka ushtruar si menaxher dege, rregullore të shkruar deri më korrik të vitit 2007 nuk ka pasur, gjatë asaj kohe i vetmi dokument i cili ka bërë përshkrimin e punës ka qenë dokumenti për punën e mbikëqyrësit senior, pozitën të cilën e ka ushtruar deri sa është emëruar si menaxher i degës, ndërsa të gjitha procedura për lejimin e kredive është bërë në bazë të urdhërave gojor të mbikëqyrësit të rangut më të lart. Më tutje ka theksuar se pasi që rregullore të shkruar nuk ka pasur deri më korrik të vitit 2007, si menaxher i degës lejimi i kredive nga ana e tij kanë shkuar në bazë të preferencave – referencave të mbikëqyrësit më të lart, të cilat zakonisht kanë qenë në formë verbale, por nuk përjashtohet edhe mundësia se kanë qenë edhe në formë të shkruar. Në vazhdim ka theksuar se si menaxheri i degës në një farë mënyrë propozimin për aprovimin apo lejimin e kredisë grupore apo kredisë individuale ka qenë ai, ndërsa agjentët për përgatitjen e dokumentacionit për degën e Malishevës dhe Prizrenit kanë qenë disa persona të cilët kanë përgatit dokumentacionin dhe pastaj kanë shkuar në komitet, ndërsa për pjesën e degës së Prizrenit ka qenë V.K. . Më tutje ka potencuar se klientët potencial të kredive grupore nuk ka qenë e domosdoshme që të kenë biznesin e regjistruar, kanë mundur të kenë një veprimtari të caktuar nga e cila kanë pasur profit që është dashur me dëshmu veprimtarin e tyre, personat fizik nuk kanë pasur mundësi të marrin kredi, në momentin e nënshkrimit të kontratës së kredisë është dashur të jenë të gjithë anëtarët prezent, ndërsa dhënja e parave të gatshme klientëve është mundësuar në bazë të rregullores të shërbimit financiar të cilat kanë pasur rregulloret e tyre. Dhe në fund ka theksuar se A.G., B.G., S.G., B.G.3, M.H. dhe B.K. nuk ka në qenë agjent të kredive pranë Finca-s.

Duke e analizuar mbrojtjen e të akuzuarit A.V. gjykata mbrojtësit të tij pjesërisht ia fali besimin, në të vërtetë i akuzuari në mbrojtjen e tij e pranon se ka qenë punëtor në Finca nga prilli i vitit 2000 deri në gusht të vitit 2007. I akuzuari në mbrojtjen e tij ika shpjeguar në detaje procedurën për dhënien e kredive e që nga deklaratat e dëshmitarëve dhe provave materiale të administruara është vërtetuar se i njëjti fare nuk i ka zbatuar këto procedura, vet i akuzuari ka shpjeguar se për dhënien e kredive agjendi i kredive ka bërë promovimin e kredive në vende të ndryshme dhe për personat e ndryshëm dhe pas interesimit të personave është marr vendim për grupe të caktuara, ku është caktuar kryetari i grupit, sekretari dhe arkëtari, e që në realitet nga dëshmitë e dëshmitarëve nuk është vepruar në këtë mënyrë pasi që janë vet dëshmitarët që kanë deklaruar se janë ftuar në një vend të caktuar e kanë dhënë kopjen e letërnjoftimit kanë nënshkruar në disa letra pa e ditur se çka po e nënshkruajnë, në disa raste të caktuara kanë marr shpërbllim në shuma të caktuar të hollave herë 20 euro herë 10 euro në raste të tjera vetëm ju është marr letërnjoftimi i dëshmitarëve pa e ditur se pse dhe në këtë mënyrë janë formuar grupe dhe janë marr kredit në prezencën edhe të akuzuarit A.V. , e në kundërshtim me procedurat mbi marrjen e kredisë. Gjithashtu i akuzuari ka deklaruar se para se ti jepen kreditë janë bërë vizita bizneseve, është bërë kërkesa për kredi, janë përgatitur të gjithë dokumentacioni dhe është dërguar tek udhëheqësi për aprovim, e që në rastin konkret një gjë e tillë nuk ka ndodhur pasi që me rastin e dhënies së kredive në dokumentacionin e përgatitur për kredi janë nënshkruar personat e caktuar respektivisht dëshmitarët e dëgjuar dhe atë pa e ditur fare se çka po nënshkruajnë e që si rezultat i kësaj të njëjtit nuk e kanë ditur se janë duke marr kredi si anëtarët të grupit, mirëpo këtë e kanë kuptuar tek pasi që udhëheqësit e grupit me të cilët janë bashkëpunuar këtu i akuzuari A.V. kanë ra në vonesë dhe nga kjo është kuptuar se ka pasur keqpërdorime gjatë dhënies së kredive tek pastaj këta persona kanë kuptuar nga zyrtarët e Finca se kanë për të paguar këste të kredisë. Gjithashtu i akuzuari A.V. ka deklaruar se për marrjen e kredisë është dashur që të jenë të gjithë anëtarët e grupit prezent ndërsa nga dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se shumica prej tyre vetëm kanë nënshkruar disa letra nuk e kanë ditur se çka po e nënshkruajnë dhe atë në

prezencën e të akuzuarve A.V. dhe V.K. , disa prej dëshmitarëve vetëm ju është marr letërnjoftimi në mënyra të ndryshme e që në këtë mënyrë janë formuar grupet pa qenë në dijeni këta persona dhe pa qenë prezent këta persona me rastin e nënshkrimit të kontratës së kredisë. Pra, në këtë pjesë të mbrojtjes gjykata ka vërtetuar se i akuzuari A.V. i ka ditur në detaje procedurat për dhënien e kredisë, mirëpo nuk i ka zbatuar këto procedura ashtu siç ka qenë i obliguar si zyrtarë që ka qenë në Finca.

E akuzuara V.K. , gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprat penale që i vihen në barre, ndërsa në mbrojtjen e saj ka deklaruar qëndron pranë deklaratës së dhënë në prokurori dhe kësaj gjykate, duke theksuar se në Finca është punësuar në vitin 2000 si nëpunëse kreditore fillimisht me një kontratë prej 3 muaj provuese, dhe pas kalimit të parashikimeve ka marrë kontratë të përhershme deri në vitin 2007, e cila kontratë ka qenë vetëm në gjuhën angleze, të cilën gjuhë e kupton mesatarisht, ndërsa në vitin 2000 nuk ke ka njohur në nivelin të cilën e njeh tani. Gjatë vitit 2006-07 ka qenë e caktuar në pozitën e nëpunëses kreditore për në degën e Malishevës dhe një pjesë të Prizrenit, dhe puna kryesore ka qenë terreni, gjetja e klientëve, klientët potencial ka në qenë ata të cilët kanë pasur një biznes ose ata të cilët dëshirojnë të fillojnë një biznes, zakonisht nëpër fshatra, duke biseduar me klientë, të cilët klientë kanë pasur për obligim që të formojnë grupe që e njohin njëri tjetrin dhe që garantojnë për njëri tjetrin sepse prej tyre nuk është kërkuar kolateral, hipotekë apo diçka tjetër. Në vazhdim ka theksuar se pas formimit të grupeve dhe kompletimit të dokumentacionit, dhe nënshkrimit të formave për klientë ka dorëzuar kërkesat për kredi në Finca, mbikëqyrësit të saj, ku gjatë atyre viteve në Malishevë ka qenë A.V. ndërsa në Prizren E.P. , dhe pa nënshkrimin e tyre nuk është aprovuar asnjë kredi, duke theksuar se pjesëmarrës për aprovimin e kredive në komitet ka qenë vetëm për klientë individual ndërsa për kredit grupe nuk ka qenë anëtare e komitetit, i cili komitet ka mundur të aprovoj, refuzoj apo të ulë shumën e kredisë, pra komiteti ka vendosur për gjithçka ata kanë nënshkruar, ndërsa nënshkrimi i saj ka qenë në fund të dokumentacionit. Në vazhdim ka theksuar se A.G. e njeh mirë, pasi që ka qenë klient i saj që nga viti 2003 dhe deri në vitin 2007 ka marrë kredi 7 apo 8 herë, dhe i cili në vitin 2006 ka marrë mirënjohje nga Finca si klient i mirë, dhe gjatë përgatitjes së dokumentacionit për te ka dhënë pozitive për marrjen e kredisë. Më tutje thekson se edhe B.G. e njeh, por nuk i kujtohet saktësisht se a ka qenë klient individual apo herën e fundit kur ka marrë kredi në vitin 2007 dhe deri në atë kohë ai ka marrë në Finca diku rreth 10 herë kredi dhe ka qenë klient i rregullt, dhe e cila ka qenë kusht për të marrë kredi tjetër. Po ashtu në vazhdim ka theksuar se S.G. e njeh, i njëjti ka qenë klient i bankës, ka pasur një biznes te Qylhani, i cili ka qenë klient i mirë deri në momentin e dështimit, duke nënkuptuar me vonesat e pagesës së kredive, brenda afatit të paraparë. Më tutje ka theksuar se edhe të akuzuarit e tjerë B.G.3 , M.H. dhe B.K. i ka njohur pasi që kanë qenë klient të saj, të cilët po ashtu kanë dështuar, pasi që ajo ka dal nga Finca. Në vazhdim ka theksuar se obligimi i saj si nëpunëse e kredive ka qenë edhe përcjellja e kthimit të kredive nga ana e klientëve për çdo ditë, ndërsa gjatë lejimit të kredive ka ndodhur që në dy raste me lejen e drejtorit, kredit i ka dhënë klientëve – kredimarrësve në dorë, ndërsa në fshatra detyra e saj ka qenë që të mbledhë të hollat dhe me i dorëzuar në zyre të gjitha këto me raporte zyrtare, ndërsa klientët të cilët kanë qenë afër me zyret e Fincës, pagesat janë kryer në zyre. Më tutje thekson se si nëpunëse kreditore nuk ka ditur se në vitin 2007 A.G. ka pasur borxh për kthimin e kredisë në shumën prej 129.719,84 euro, ndërsa B.G. poashtu ka pasur borxh shumën prej 256.567,30 euro, ndërsa edhe S. G. ka pasur borxh për kthim të kredisë shumën prej 429.537,49 euro. Ndërsa në fund thekson se përveç këtyre personave të lartpërmendur që kanë marrë kredi, gjatë periudhës dhjetor 2006 deri në maj të vitit 2007 kanë qenë mbi 500 klienta, ndërsa si klient i grupit ka qenë edhe B.K. i cili deri në shtator të vitit 2006, ka marrë kredi 7-8 herë si klient i rregullt, dhe njëherit ka qenë edhe si arkëtarë i grupit pasi që ka pasur një dyqan dhe i tërë dokumentacioni ka qëndruar tek ai në dyqan, i cili dyqan ka qenë edhe pikë takimi me klienta.

Duke e analizuar mbrojtjen e të akuzuarës V.K. gjykata ka vërtetuar se e njëjta ka punuar në Finca prej vitit 2000 deri në vitin 2007. Gjatë vitit 2006/2007 e njëjta ka punuar si nëpunëse kreditore

në degën e Malishevës dhe me një pjesë të Prizrenit dhe se puna kryesore e saj ka qenë gjetja e klientëve dhe atë zakonisht nëpër fshatra, për formimin e grupeve të klientëve që e njohin njëri tjetrin dhe që garantojnë për njëri tjetrin. E akuzuara është mbrojtur se pas formimit të grupeve dhe kompletimit të dokumentacionit dhe nënshkrimit të formave për klient i ka dorëzuar kërkesat për kredi në Finca, mbikëqyrësit të saj e që në atë kohë në Malishevë ka qenë A.V. ndërsa në Prizren E. P. . Nga dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se e akuzuara nuk i ka zbatuar procedurat e kreditimit pasi që janë vetë dëshmitarët të cilët kanë deklaruar se në prezencën e të akuzuarës V.K. ka nënshkruar disa letra duke mos e ditur se çka po nënshkruan, pra e akuzuara nuk ua ka shpjeguar dëshmitarëve ashtu siç ka qenë e obliguar sipas detyrës që e ka pasur që të gjithë klientët për çka po nënshkruajnë, çfarë detyrimesh kanë, çfarë obligimesh kanë karshi udhëheqësit të grupit si dhe karshi Institucionit Finca për faktin se janë duke marrë kredi dhe se janë të obliguar që kredinë ta kthejnë, por se e njëjta vetëm lejon që këta persona të nënshkruajnë pa e ditur fare se çka janë duke nënshkruar. Në këto rrethana e akuzuara lejon që të jepen kreditë në kundërshtim me procedurat për dhënien e kredisë.

I akuzuari B.K. gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprat penale që i vihen në barre, ndërsa në mbrojtjen e tij ka deklaruar se qëndron pranë deklaratës së dhënë në prokurori me dt. 03.03.2008, duke theksuar se gjatë vitit 2006 deri në vitin 2007 por edhe më parë në Finca ka marrë kredi grupore. Në atë kohë ka jetuar në Rogovë të Komunës së Gjakovës dhe kishte dëgjuar se Finca është duke dhënë kredi, dhe me tre persona ka shkuar në shkollën fillore të fshatit dhe janë takuar me A.V. dhe V.K. dhe aty kanë filluar procedura e marrjes së kredisë, ashtu që çdo dy javë ata kanë mbajtur trajnime rreth aplikimit të kredisë, sqarime për mënyrën e marrjes dhe kthimit të kredisë, dhe pas kësaj nga ana e tyre është aprovuar aplikacioni, ku nga ana e tyre është nënshkruar i gjithë dokumentacioni e nevojshme për marrjen e kredisë dhe dorëzimin e të hollave. Në pyetjen e prokurorit se në deklaratën e tij në shqyrtim gjyqësor se grupin e kanë formuar zyrtarët e Fincës V.K. dhe A.V. , ndërsa në deklaratën e tij të dhënë në prokurori në fq. 3 pasusi 6 reshti i 2 keni thënë se: uje ju kam ndihmuar me bërë grup, me zgjanu aktivitetin dhe kanë marrë shumë veta kredina, cila është e vërteta, i akuzuari është përgjigjur se ai ka ndihmuar V.K. dhe A.V. që ta formojnë grupe, sepse kredinë e tij ka pasur nevojë të marrë vetëm për nevojat e tij personale. Në vazhdim të mbrojtjes së tij ka theksuar se ai asnjëherë nuk ka qenë udhëheqës i grupit, ndërsa ai personalisht Fincës nuk i ka asnjë kredi borxh, por se anëtarët e tij të familjes kanë marrë kredi të cilat kanë mbetur borxh dhe për këto vonesa personalisht ka shkuar në Finca dhe ka biseduar me V.R. për një zgjidhje që ato kredi të i kthejë në kiste më të vogla, mirëpo ato nuk janë marrë në konsideratë nga ai. Ndërsa në fund thekson se kreditë që kanë mbetur borxh janë marrë në kohën e njëjtë pra ato janë marrë një pas një, pa u përfunduar kredia tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.K. gjykata ia falë besimin për faktin se i njëjti në mbrojtjen e tij e ka pranuar se disa herë kishte marrë kredi në Finca, por këto kredi i ka të shlyera, e që ky fakt vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarëve F.Z., Xh.R. dhe A.D. të vetmit dëshmitarë të dëgjuar lidhur me të akuzuarin B.K., pasi që dëshmitarët tjerë të dëgjuar fare nuk kanë pas të bëjnë me këtë të akuzuar, të cilët deklarojnë se e kanë nënshkruar si garantues për të akuzuarin B.K. që i njëjti të marrë një kredi në Finca dhe se B.K. ata nuk i ka mashtruar e që për gjykatën ka qenë e besueshme pasi që janë vet dëshmitarët që tregojnë se e kanë ditur se për çka janë duke nënshkruar dhe atë si garantues për të akuzuarin B.K. dhe se i njëjti nuk i ka mashtruar e që për gjykatën nëse të njëjtit apo edhe vet i akuzuari B.K. ka ra në vonesë për kthimin e kredive kjo nuk paraqet vepër penale.

Nga të gjitha provat e administruara, nga n dëgjimi i dëshmitarëve në rastin konkret nuk është kontestuese dhe në tërësi është vërtetuar, te akuzuarit A.V. dhe V.K. kanë qene te punësuar ne "FINCA" ndërsa jo edhe i akuzuari B.K.. I akuzuari A.V. ka qenë menaxher i degës në Malishevë, ndërsa e akuzuara V.K. ka qenë analiste kreditore në Malishevë e cila është marrë edhe me një numër

të caktuar të klientëve në Prizren, detyra e të akuzuarës V.K. analiste e kredisë kanë qenë gjetja e klientëve potencial, promovimi i programit, analizimin e biznesit të klientëve, përgatitja e dokumentacionit dhe propozimi i kredive në komitet, ku së bashku me menaxherin e degës në komitet i kanë aprovuar këto kredi me rastin e vendosjes për kërkesat në fjalë, të cilat komitete të kredive janë mbajtur në të gjitha degët bankës, përveç shumave të mëdha të cilat e tejkalojnë kompetencën e menaxherit. Sipas rregullores së brendshme të FINCA gjatë vitit 2006 për kredit grupore ka qenë e mundur të jepet kredia në vend të biznesit (klientit), ndërsa në vitin 2007 klienti është dashur personalisht që të jetë në zyrat e Fincës me dokumente personale për të tërhequr kredinë, ndërsa për marrjen e kredisë secili anëtarë i grupit kanë pasur për obligim të nënshkruajnë personalisht dokumentet kredisë dhe tërheqjen e kredisë. Kredite grupore kanë dalluar prej kredive individuale për shkak të anëtarësisë dhe në bazë të rregullores ka funksionuar në baza solidare, është kërkuar pjesëmarrja e minimum 3 anëtarëve të grupit pa kolateral dhe është dhënë në baza solidare në mes tyre ashtu që në rast se një anëtarë i grupit nuk e paguan kredinë atëherë anëtarët e tjerë duhet të e mbulojnë borxhin e atij anëtari.

Deri në vitin 2006/07 nuk janë vërejtur parregullsitë e të akuzuarve, por në momentin e ndaljes së shpërndarjes së kredive janë paraqitur vonesat e kredive dhe me atë rast janë bërë vizitat e klientëve, ku njëri prej klientëve kishte deklaruar se është përgjegjës për disa anëtarë të grupeve të cilët kanë marrë kredi dhe nga kjo deklaratë ka rezultuar se ai nuk ka pasur të drejtë që të marrë kredi në emër të personave tjerë. Gjatë vitit 2007 në Finca është bërë një auditim i brendshëm dhe gjatë procesit të auditimit ka gjetur moszbatim të kriterëve të kreditimit nga ana e të akuzuarve ashtu siç është kërkuar me procedurat e kreditimit. Të gjeturat në raportin e auditimit ka qenë mos zbatimi i rregullores së brendshme të kreditimit, siç janë dhënia e kredisë për personat të cilat nuk i kanë plotësuar kushtet për marrjen e kredisë, po ashtu dhënia e kredisë për klientë jo ekzistues të cilët nuk kishin aplikuar për kredi, (është dhënë kredia pa dijen e klientëve), deri tek ky konstatim gjatë auditimit ka ardhur pas kontrollimit të dokumentacionit të klientëve, takimit me klientë, takimit me tre përgjegjës për mbledhjen e klientëve, si dhe nga deklaratat e klientëve se të njëjtit nuk kanë marrë kredinë, të njëjtit nuk janë nënshkruar të marrëveshjeve për kredinë, po ashtu disa prej klientëve kanë deklaruar se kanë nënshkruar marrëveshjet por se kanë marrë parat vetëm për nënshkrim. Prej personave përgjegjës për mbledhjen e klientëve, zyrtaret e Finca janë takuar me A.G. , i cili kishte marrë një shumë të caktuar të kredive përmes personave të tjerë, ku kishte ardhur në zyrat e Fincës dhe ka deklaruar se është posedues i 12 apo 13 kredive në atë kohë të cilat i ka marrë me klientë të cilët kanë nënshkruar dhe një numër të klientëve që nuk kanë qenë prezent por kanë marrë kredinë nga punëtorët A.V. dhe V.K. , përveç këtij personi në këto parregullsi ka qenë të përfshirë edhe B.G. , S.G., dhe djali i S.G. , B.G.3 i cili në Finca ka dhënë deklaratën e njëjtë si të A.G. se ka qenë i përfshirë në parregullsi ra, të cilët në deklaratën e tyre të dhe në FINCA në muajin gusht të vitit 2007 e kanë pranuar si detyrim karshi Fincës shumë në rreth 890.000 euro. Të akuzuarit A.V. , V.K. , në cilësinë e personave të autorizuar për dhënie të kredive në grup dhe kredive individuale në Institucionin Mikrofinanciar “Finca”, së bashku me klientët (agjentët) e autorizuar A.G., B.G., S.G., B.G.3 në mënyrë të drejtpërdrejt e kanë dëmtuar Institucionin Mikrofinanciar “Finca” në shumë prej 889.637,25 €. Personat që kanë formuar grupe apo persona përgjegjës janë të akuzuarit A.G. në total me 93 klient të mashtruar, B.G. në total prej 283 klient të mashtruar, S.G. në total prej 346 klient të mashtruar, ku përsëriten emrat e klientëve të njëjtë në grupe të ndryshme dhe me emërtime të ndryshme. Në mesin e këtyre klientëve janë prezent edhe emrat e dëshmitarëve të dëgjuar në shqyrtimin kryesor. Sipas mendimit të ekspertizës duke u bazuar në Libër-Udhëzues të kredive për Finca dhe në Standardet e Kontabilitetit Ndërkombëtar (SNK), dhe Standardet e Kontabilitetit të Kosovës (SKK), të cilat standarde janë të aplikueshme në Kosovë se përgjegjësia për shpërdorimin e detyrës zyrtare bien jo vetëm në personat përgjegjës A.V. dhe V.K. por edhe në menaxhmentin e lartë, të cilët kanë punuar dhe vepruar në atë kohë. Sipas ekspertit përgjegjësia materiale – financiare bien mbi klientët (agjentët) e autorizuar të tyre A.G. me 137.579, 74€, B.G. me 308.028,96€ dhe S.G. me

444.028,55€, duke e dëmtuar institucion “Finca” në Prizren në shkaktimin e humbjes prej 889.637,25€.

Vet fakti se këtu te akuzuarit A.V. e V.K. ne kundërshtim me rregullat e bankës kane kryer veprime kreditore duke përpiluar dokumentacion pa prezencën dhe vullnetin e kredi marrësve, kanë dhënë kredi për personat të cilat nuk i kanë plotësuar kushtet për marrjen e kredisë, po ashtu dhënia e kredisë për klientë jo ekzistues të cilët nuk kishin aplikuar për kredi, është dhënë kredia pa dijen e klientëve, pastaj mënyra e pagesës nga të njëjtit vetëm për udhëheqësit e grupit ka vërtetuar se te akuzuarit kane shkelur autorizimet e veta si zyrtar te Finca me qrast kane perfituar per veti apo personat e trete duke e dëmtuar institucionin Finca për shumen e përmendur me larte.

Një fakt te tille e vërteton edhe pranimi i te akuzuarve A.G., B.G. dhe S.G. para zyrtarëve te Finca se me të vërtetë paratë ishin te destinuara për ta vet, e në këtë mënyrë i kanë nxjerre paratë nga Finca, të njëjtit edhe japin deklarate me shkrim ne prezence edhe te akuzuarit A.V. se i marrin për sipër të gjithë shumen e cila konsiderohet se është shkaktuar dëm ne Finca.

Në këtë mënyrë nga te gjitha te cekurat me larte gjykata gjeti se ne veprimet e te akuzuarve formohen te gjitha elementet e veprës penale te shpërdorimi i pozitës zyrtare apo i autorizimit nga neni 339 pr. 3 lidhur me par. 1 dhe nenin 23 te KPK dhe të njëjtit i shpalli fajtor dhe iu shqiptoj dënimin si ne shqiptim të këtij aktgjykimi.

Sa i përket vepre penale te mashtrimit gjykata ne shqyrtimin kryesore pas administrimit te të gjitha provave rrethanave dhe fakteve ka konstatuar se me asnjë prove nuk është vërtetuar se te akuzuarit kanë kryer këtë vepër penale, kjo për faktin se nga dëgjimi i te gjithë dëshmitarëve është vërtetuar se nuk kane qene te akuzuarit ata qe kane komunikuar me dëshmitaret duke iu kërkuar letërnjoftimet por se kane qene te akuzuarit A.G., S.G. dhe B.G. ata te cilët kane gjetur klientë në këtë rast dëshmitarët e dëgjuar, ne disa raste vetëm ju kanë marrë letërnjoftimet duke formuar grupe për marrjen e kredive grupore, po ashtu të njëjtit ju kane marre letërnjoftimet duke ju dhanë nga një shpërblim te vogël ne para por pa ua shpjeguar se për çka me të vërtetë po ua merrnin letërnjoftimin, pra te akuzuarit A.V. dhe V.K. nuk kane komunikuar me këta dëshmitarë përveç qe kane qene prezent ne momentin e dhënies së nënshkrimeve nga ta, ndërsa fakti se të njëjtit nuk ua kanë shpjeguar rregullat e marrjes se kredisë këto veprime janë inkriminuar ne veprën penale te shpërdorim i pozitës zyrtare apo i autorizimit nga neni 339 pr. 3 lidhur me par. 1 dhe nenin 23 te KPK dhe të njëjtit janë shpallur fajtor të shpjeguar si me larte.

Lidhur me veprën penale te mashtrimit e qe ka te bëjë me te akuzuarin B.K. gjykata ka vërtetuar se me asnjë prove nuk është vërtetuar se i njëjti te ketë kryer këtë vepër penale kjo është vërtetuar nga vet dëshmitë e dëshmitarëve F.Z., Xh.R. dhe A.D. e të cilët ishin te vetmit dëshmitarë qe janë dëgjuar lidhur me te akuzuarin B.K. të cilët kane dëshmuar se ia kanë dhënë letërnjoftimin dhe kane nënshkruar dokumentet qe B.K. te merr kredi ve, ndërsa pas kësaj A.V. dhe V.K. në zarf ia kishin dhënë parat B.K. , dëshmitarët vet kane deklaruar se për kredinë të cilën e ka nënshkruar si garantues nuk ka qenë te mashtruar nga i akuzuari B.K. .

Sa i përket vepre penale te falsifikimit te dokumentit ne bashkëkryerje nga neni 332 par. 3 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 23 te KPK-se prokurori i shtetit gjate shqyrtimit kryesore ka hequr ore nga akuza për shkak te parashkrimit prandaj gjykata ka marre aktgjykim refuzues sa i përket kësaj vepre penale.

Gjykata nga të cekurat më lartë, padyshim ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve A.V. e V.K., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit në

bashkëkryerje nga neni 339 par. 3 lidhur me par. 1 dhe neni 23 të KPK, prandaj edhe të njëjtin e shpalli fajtor për këtë vepër penale dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në neni 64 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve, gjendjen e ekonomike, se janë mbajtës të familjes, deri më tani nuk kanë ardhur asnjëherë ndesh me Ligjin, në gjykim kanë pasur qëndrim korrekt, kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 34 dhe 42 i KPK-së dhe ky dënim i tillë, i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Vendi mbi udhëzimin e të dëmtuarve në kontest civil është marrë në pajtim me nenin 463 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 451 dhe 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,
P.nr.9/2014 më datë 01.12.2016**

**Procesmbajtësja
Birsen Kume**

**Kryetari i trupit gjykues
Skender Çoçaj**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.